

BE-ja: Priten pasoja nëse nuk zbatohet marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

OPOZITA ËSHTË KONSTRUKTIVE, QYTETARËT TË ZHGËNJYER ME QEVERINË KURTI



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka theksuar se qytetarët janë të zhgënjyer me qeverinë Kurti. Ai ka thënë se për dy vjet qeverisje të Kurtit nuk kanë parë asnjë veprim dhe rezultat konkret. Ai

ka bërë me dije se opozita është konstruktive, por që në realitet nuk ka pasur çfarë të kritikojë për faktin që qeveria aktuale nuk pa punuar asgjë. Në këtë intervistë, Lekaj ka folur edhe për procesin gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

Selimit, Jakup Krasniqit dhe bashkëlufetarëve të tjerë. Ai ka thënë se UÇK-ja është vlera më e madhe kombëtare e Kosovës, duke theksuar se Gjykata Speciale ka devijuar nga mënyra e funksionimit dhe ideja mbi atë se çfarë është krijuar

SPECIALJA NË 'MBYLLJE HERMETIKE': KATËR DITË SEANCA PRIVATE PËR DËSHMITAREN E PARË



KUSHTETUTA E KOSOVËS NUK ËSHTË LIBËR I SHENJTË! PËR T'U FUNKSIONALIZUAR SHTETI I KOSOVËS, AJO DUHET TË NDRYSHOJË!

Shkruan: Valon MURATI



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



FMN-ja: NORMAT E INTERESIT DO TË MUND TË BIEN NË NIVELET PARA COVIDIT F. 2

RUBINII: KAM KUJTIME TË MIRA TË PUNËS ME LIDERËT E UÇK-së F. 4

NË KALABRI INAUGUROHET SHESHI ME EMRIN "KOSOVA" F. 5

EKONOMI



SHTRENJTIMI I RRYMËS SINJALIZON SHTRENJTIMIN EDHE TË PRODUKTEVE TË TJERA F. 7

NXIRREN TË GJITHË MINATORËT E NGUJAR NË MINIERËN E "TREPÇËS" F. 8

SPORT



CITY DEKLASON BAYERNIN, INTERI TRIUMFON NË LISBONË F. 14

FMN-ja: Normat e interesit do të mund të bien në nivelet para Covidit

UASHINGTON, 11 PRILL - Normat e interesit në ekonomitë e mëdha pritet të bien në nivelet para pandemisë së koronavirusit për shkak të produktivitetit të ulët dhe plakjes së popullsisë, ka thënë Fondi Monetar Ndërkombëtar në parashikimet e fundit.

Ky institucion ka thënë se rritja e çmimeve të huamarrjes pritet të jetë “e përkohshme”, pasi inflacioni i lartë të vihet nën kontroll.

Bankat Qendrore në Shtetet e Bashkuara, Mbretëri të Bashkuar, Evropë dhe vende të tjera i kanë rritur normat e interesit për ta luftuar rritjen e çmimeve, që ndryshe njihet edhe si inflacion.

Në Mbretëri të Bashkuar

inflacioni është në nivelin më të lartë në gati 40 vjet për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë dhe produkteve ushqimore.

Një numër faktorësh janë duke ndikuar në rritje të inflacionit, përfshirë luftën e Rusisë në Ukrainë, e cila ka ndikuar në rritje të çmimeve të energjisë. “Kur inflacioni të vihet nën kontroll, Bankat Qendrore të ekonomive të avancuara do të mund t’i lehtësojnë politikën monetare dhe t’i ulin normat e interesit në nivelet para pandemisë”.

Ky institucion, me bazë në Uashington, ka thënë se plakja e popullsisë do të jetë, po ashtu, një faktor që ndikon në ulje të inflacionit.



Duke sqaruar pse është përmendur ky fakt, George Godber, menaxher në kompaninë “Polar Capital”, ka

thënë se ata kanë tendencë të shpenzojnë më pak. “Shpenzimet që bëjnë njerëzit kur janë në të 20-at, 30-at dhe

40-at e tyre janë më të lartat, ndoshta për shkak të blerjes së patundshmërisë, krijimit të çifteve, blerjes së makinës apo çfarëdo tjetër dhe, me kalimin e kohës, ulen shpenzimet dhe konsumin”, ka thënë ai për transmetuesin britanik BBC.

Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

Shkup: Formohet komisioni për ndryshimet kushtetuese, opozita nuk merr pjesë

SHKUP, 11 PRILL - Maqedonia e Veriut e ka nisur procedurën për ndryshimet kushtetuese me formimin e komisionit për hartimin e amendamenteve, ka bërë me dije Ministria e Drejtësisë.

Ndryshimet kushtetuese duhet të bëhen për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, si popull shtetformues, ashtu siç parashihet me marrëveshjen me Bullgarinë, bazuar në atë që njihet si “propozimi francez” për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes dy shteteve për identitetin maqedonas, gjuhën dhe dallimet historike.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Drejtësisë, komisioni përbëhet nga një përfaqësues prej dhjetë partive politike dhe nga një përfaqësues nga presidenti i Republikës, Sekretariati për



Çështje Evropiane dhe Ministria e Punëve të Jashtme. “Propozuese e ndryshimeve është qeveria dhe, pas përgatitjes së amendamenteve, propozimi do të kalojë në të gjitha trupat punuese të

Kuvendit, ndërsa në të njëjtën kohë do të mbahen debate publike ekspertësh ku ekspertë, parti, organizata të shoqërisë civile dhe institucione të tjera do të mund t’i shprehin qëndrimet e tyre”, thuhet në njoftimin e

Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni bojkotohet nga opozita maqedonase dhe ajo shqiptare, të cilat kanë qëndrime të ndryshme lidhur me ndryshimet e që synohen të miratohen.

Lëvizja Besa kërkon që ndryshimet ta përfshijnë edhe zgjidhjen e statusit të gjuhës shqipe, e cila në Kushtetutë është e definuar si gjuhë që e flasin mbi 20 për qind të popullatës së përgjithshme në Maqedoninë e Veriut.

Të njëjtën e kërkon edhe partia tjetër Alternativa, përfshirë edhe miratimin e një ligji tjetër për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ndërkohë, opozita maqedonase, e drejtuar nga VMRO DPMNE, ka thënë se do t’i mbështeste këto ndryshime nëse miratohet

propozimi i saj bazuar në modelin kroat, përkatësisht definimin e Maqedonisë së Veriut si “shtet nacional të maqedonasve dhe shtet të pakicave të tjera etnike që jetojnë në të”.

Partitë e tjera politike kanë refuzuar propozimin e VMRO-së, si dhe kërkesën për takim të liderëve të partive politike.

Kryeministri maqedonas, Dimitar Kovačevski, njëherësh kryetar i LSDM-së, ka thënë se Maqedonisë së Veriut i nevojitet “model i bazuar në shoqërinë maqedonase”.

Ndryshimet kushtetuese miratohen me dy të tretat, apo 80 nga 120 deputetët e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Por, shumica parlamentare aktualisht ka 64 vota, që do të thotë se pa votat e opozitës ndryshimet nuk mund të bëhen.

Rrjedhja e dokumenteve nga Pentagoni, rrezik për sigurinë kombëtare

UASHINGTON, 11 PRILL - Rrjedhja e disa dokumenteve të klasifikuara të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes paraqet rrezik “shumë serioz” për sigurinë kombëtare, tha Pentagoni.

Dokumentet duket se përfshijnë informacione të ndjeshme në lidhje me luftën në Ukrainë si dhe për Kinën dhe aleatët e ShBA-së.

Hetimet për ta përcaktuar burimin e rrjedhjes së tyre tashmë kanë nisur.

Dokumentet u shfaqën fillimisht në platformat online si “Twitter”, 4chan dhe “Telegram”

si dhe në një server “Discord” për videolojën “Minecraft”.

Përveç informacioneve shumë të hollësishme në lidhje me luftën në Ukrainë, disa nga dokumentet e zbuluara thuhet se hedhin dritë edhe mbi informacione të ndjeshme për aleatët e ShBA-së.

Një burim i afërt me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky tha për CNN-in se Ukraina ka ndryshuar tashmë disa nga planet e saj ushtarake për shkak të rrjedhjes së dokumenteve.

Dokumentet e tjera thuhet se fokusohen në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë në



Lindjen e Mesme si dhe në rajonin e Indo-Paqësorit.

Chris Meagher, ndihmës i sekretarit amerikan të Mbrojtjes për çështjet publike, tha se rrjedhja e dokumenteve paraqet “rrezik shumë serioz për sigurinë kombëtare dhe ka potencial për të përhapur dezinformata”. “Ne jemi duke hetuar sesi ka ndodhur kjo”, tha ai.

Rasti po hetohet nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë së bashku me zyrtarë nga Pentagoni, Shtëpia e Bardhë dhe të tjerë në qeverinë amerikane.

BE-ja: Priten pasoja nëse nuk zbatohet marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 PRILL - Bashkimi Evropian është duke insistuar që Kosova dhe Serbia kanë për obligim t'i zbatojnë të gjitha pikat e Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve, bashkë me aneksin për të, në të kundërtën do të përballen me pasoja. Palët kanë arritur pajtueshmëri për Marrëveshjen për normalizim të marrëdhënieve më 27 shkurt në Bruksel, ndërsa për aneksin më 18 mars në Ohër.

Lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është deklaruar të martën sërish zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Ai është përgjigjur në pyetjet rreth deklaratave të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është cituar - nga mediet në Serbi - të ketë thënë se do t'i zbatojë disa pjesë të Marrëveshjes, por disa të tjera nuk do t'i pranojë.

Vuçiqi, po ashtu, është cituar të ketë thënë se qëndrimet e tij për moszbatim të disa pikave të Marrëveshjes ua ka shprehur qartë disa bashkëbiseduesve evropianë. Një deklaratë e tillë e presidentit të Serbisë është në kundërshtim me deklaratat e kryediplomatit të BE-së, Josep Borell, se palët janë pajtuar për të gjitha pikat e Marrëveshjes



dhe për të gjitha pikat e aneksit për zbatimin e saj.

Duke u përgjigjur në pyetjen se "a është e vdekur Marrëveshja, pasi njëra palë thotë se nuk do t'i zbatojë disa pjesë të saj", zëdhënësi i BE-së ka thënë se "Marrëveshja është gjithësi e gjallë dhe në lëvizje". "Përderisa nuk komentojmë deklaratat e mundshme, pa e njohur kontekstin, dhe pa dashur të hymë në komente të secilës deklaratë rreth kësaj Marrëveshjeje, dua të fokusohem në Marrëveshjen si të tillë. Të dyja palët, Kosova

dhe Serbia, u pajtuan në Ohër që ta nisin menjëherë zbatimin e të gjitha pjesëve të Marrëveshjes, përfshirë edhe aneksin. Kjo është ajo për çfarë jemi pajtuar. Ky është obligimi politik që të dyja palët morën dhe ajo që shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së presin nga ato", ka thënë Stano, duke përsëritur se është shumë qartë se ajo për çfarë janë pajtuar palët, duhet të zbatohet. "Pikat e Marrëveshjes, si dhe aneksi, do të përfshihen në kapitullin 35 të kornizës negociuese në rastin e Serbisë. Kjo do të thotë

se Serbia ka obligim kontraktual që t'i zbatojë pikat e Marrëveshjes nëse dëshiron të arrijë progres në procesin e anëtarësimit. Pra, kemi një marrëveshje dhe një obligim që ajo të zbatohet, pa zgjedhur pjesë të saj", ka thënë Stano duke shtuar se moszbatimi do të ketë pasoja edhe për reputacionin ndërkombëtar. Sipas tij, zbatimi është kyç për palët që të dëshmojnë se sa janë partnerë të besueshme për BE-në dhe vendet anëtare. Mes të tjerash, Stano ka thënë se do të monitorohet qartë

niveli i zbatimit dhe nëse nuk zbatohen pjesë të Marrëveshjes, do të ketë pasoja për rrugëtimin e Serbisë drejt BE-së, por edhe pasoja financiare. "Monitorimi i zbatimit në terren, i veprimeve të palëve, do të jetë mjeti kryesor i Bashkimit Evropian, vendeve anëtare dhe bashkësisë ndërkombëtare, për ta gjykuar përparimin, dhe a është apo jo marrëveshja gjallë. Dhe natyrisht do të ketë pasoja. Do të ketë pasoja politike, pasoja për reputacion, por edhe pasoja financiare" ka thënë ai. Kurti dhe Vuçiqi janë pajtuar për Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve më 27 shkurt dhe për planin e zbatimit më 18 mars.

Ndonëse ato nuk i kanë nënshkruar dokumentet, BE-ja ka thënë se marrëveshjet janë ligjërisht obliguese.

Marrëveshja me 11 nënë, e bërë publike më 27 shkurt, nuk e obligon Serbinë ta njohë Kosovën, por kërkon nga të dyja vendet t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njera-tjetres, përfshirë: pasaportat, diplomatat dhe targat.

Kosova dhe Serbia kanë arritur dhjetëra marrëveshje prej fillimit të dialogut, por shumica e tyre nuk janë zbatuar dhe palët kanë fajësuar njera-tjetren për ngecje.

Specialja në 'mbyllje hermetike': Katër ditë seanca private për dëshmitaren e parë

HAGË, 11 PRILL - Të martën u paraqit e para dëshmitare në rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, por Dhomat e Specializuara vendosën të censurojnë çfarëdo përgjigje që kjo grua do të japë para Trupit Gjyqësor. Kjo pritet të ndodhë në çështjen e saj edhe gjatë katër seancave të ardhshme, raporton "Klan Kosova".

Një gjë e tillë u vendos me kërkesë të Prokurorisë Speciale, meqë kërkoi të përfshijë materiale të reja në lidhje me dëshminë e dëshmitares së mbrojtur.

Ky vendim u kundërshtua ashpër nga mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së me arsyetimin se nuk është në përputhje me rregullat e Gjykatës Speciale. E gjitha pasi prokuroria kërkoi të përfshijë në cilësinë e materialit përgatitor shtesë, paragrafët 18 deri në 21, krahas materialit që përmban dëshminë e gruas së panjohur e cila konfirmoi se është intervistuar dy herë në Prishtinë nga prokurorët specialë.

Pas një përballjeje mes mbrojtjes, prokurorisë dhe kreut të trupit gjyqësor, prokuroria kërkoi që e tërë dëshmia katërditore të mbahet në seancë



të mbyllur, gjë që u aprovua nga kryegjykatësi.

Mbrojtja tha se sipas rregullores këto materiale mund të dorëzohen gjashtë javë pasi të bëhet kërkesa e jo në këtë mënyrë. "Është pak proces i çuditshëm kështu", u shpreh mbrojtja.

Gjykatësi tha se mbrojtja ka në dispozicion 14 orë për pyetje drejtuar dëshmitares së mbrojtur. Në fakt, "mbyllja hermetike" e

Speciales është ajo që e ka karakterizuar këtë institucion të drejtësisë që nga nisja e punës së saj. Madje akuzat për këtë sjellje ndaj Speciales kanë pasur edhe avokatët mbrojtës.

Këta të fundit disa herë janë ankuar se Prokuroria e Specializuar ka "fshehur" materiale shfajësuese, më pas edhe materialet e tjera që do të duheshin të zbuloheshin në kohë për të mundësuar mbrojtje

efektive. Për më tepër, Prokuroria e Specializuar pretendonte që gjyqin ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ta niste në mes të vitit 2021, ndonëse avokatët thoshin se një gjë e tillë është përtej absurdes. Gjyqi ndaj krerëve të UÇK-së nisi javën e kaluar me deklaratat hyrëse të Prokurorisë, mbrojtjes si dhe avokatëve të viktimave.

Nga pretendimet e prokurorisë,

të zbardhura deri tash, është zbuluar se akuzat ndaj krerëve të UÇK-së nuk kanë të bëjnë asgjë me trafikimin e organeve, për hetimin e të cilave edhe është themeluar ky institucion që paguhet miliona euro për ta kryer punën e vet. Për këtë vit janë parashikuar gjithsej 81 seanca gjyqësore ndaj krerëve, kurse në procedurë janë gjithsej 140 viktima pjesëmarrëse dhe rreth 300 dëshmitarë.



FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

Opozita është konstruktive, qytetarët të zhgënjyer me qeverinë Kurti

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka theksuar se qytetarët janë të zhgënjyer me qeverinë Kurti. Ai ka thënë se për dy vjet qeverisje të Kurtit nuk kanë parë asnjë veprim dhe rezultat konkret. Ai ka bërë me dije se opozita është konstruktive, por që në realitet nuk ka pasur çfarë të kritikojë për faktin se qeveria aktuale nuk ka punuar asgjë. Në këtë intervistë Lekaj ka folur edhe për procesin gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe bashkëlufëtareve të tjerë. Ai ka thënë se UÇK-ja është vlera më e madhe kombëtare e Kosovës, duke theksuar se Gjykata Speciale ka devijuar nga mënyra e funksionimit dhe ideja mbi atë se çfarë është krijuar

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 11 PRILL - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka kritikuar qeverinë Kurti për mospunë. Ai ka thënë se për dy vjet qytetarët e Kosovës janë zhgënjyer me këtë qeveri. Lekaj në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka thënë se qeveria Kurti do të mbahet mend vetëm për politizimin e ndërmarrjeve publike, rritjen e çmimeve dhe mosrealizimin e premtimeve, sidomos të atyre ekonomike. Ai ka theksuar se edhe pse opozita ka qenë konstruktive, nuk ka

pasur se për çfarë ta kritikojë këtë qeveri për shkak të mospunës.

Në këtë intervistë Lekaj ka folur edhe për procesin gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe bashkëlufëtareve të tjerë. Ai ka thënë se UÇK-ja është vlera më e madhe kombëtare e Kosovës. "Çfarëdo gjykimi nuk mund ta njollojë vlerën dhe kontributin e pjesëtarëve dhe komandantëve të UÇK-së. Gjykata ka devijuar pak mënyrën e funksionimit dhe idenë mbi atë se çfarë është krijuar. Më pengon tendenca që krerët e UÇK-së të përgënjeshtrohen dhe

etiketohen me të pavërteta", ka thënë Lekaj.

Deputeti i AAK-së pret që katërshja e UÇK-së të shpallet e pafajshme. "Presim drejtësi e liri për të gjykuarit, pasi po duket se kjo është duke munguar. Presim dhe do të ishte mirë që edhe ndërkombëtarët të jenë të përfshirë në gjykimin e drejtë", ka thënë deputeti Lekaj, i cili ka qenë ushtar dhe mjek i ushtarëve të UÇK-së.

"Epoka e re": Z. Lekaj, çfarë vlerësimi keni për punën dyvjeçare të qeverisë Kurti?

Lekaj: Për dy vjet qeverisje të Kurtit nuk kemi parë asnjë veprim dhe rezultat konkret.

Disa nga të këqijat e qeverisjes janë: humbja e madhe ekonomike qysh nga niveli makroekonomik, në nivel të mikroekonomisë; moslejimi i qeverisë që qytetarët e Kosovës të tërheqin 30 për qind të Trustit; rritja e çmimit të shportës familjare; rritja e çmimit të energjisë për dy herë radhazi; rritja e çmimit të derivateve në ekstrem, rritja e çmimit të tatimit në pronë në vlerë 100-300 për qind, politizimi i të gjitha ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe ministrive; mungesa e investitorëve të huaj dhe mospërkrahja e bizneseve e ndërmarrjeve kosovare; mosshuarja e AKP-së dhe moskrijimi i Bankës Zhvillimore dhe Fondit Sovran.

"Epoka e re": Këto dy vjet të qeverisë, kanë qenë të shpresës apo zhgënjimit?

Lekaj: Mbi këto fakte që i thashë, qytetarët e vendit kanë pasur vetëm zhgënjim.

"Epoka e re": AAK-ja është partia e vetme opozitare që e ka mbështetur qeverinë Kurti sa i përket marrëveshjes me Serbinë.

Pse?

Lekaj: Marrëveshja me Serbinë është një marrëveshje e cila i ka dhanë Kosovës mundësinë e vazhdimit të shumë proceseve të tjera. Është një marrëveshje e garantuar nga fuqitë perëndimore, saktësisht e planit franko-gjerman. Është koha të ndahen një herë e përgjithmonë rrugët me Serbinë dhe të vazhdojmë tutje në proceset integruese të Evropës.

"Epoka e re": Brenda kësaj marrëveshjeje është edhe Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Çfarë vlerësimi keni për këtë Asociacion, i cili ishte kundërshtuar në kohën kur Kurti ishte në opozitë?

Lekaj: Ende nuk dihet formati konkret i funksionimit të Asociacionit. Ne e kemi përkrahur marrëveshjen në të cilën nuk parashihet Asociacioni me kompetenca ekzekutive. Do ta kundërshtojmë një Asociacion me kompetenca ekzekutive nëse ai do të bëhet në realitet dhe do ta rrezikojë shtetësinë dhe të drejtën e Kosovës.

"Epoka e re": Krahas punës së

Në Kalabri inaugurohet sheshi me emrin "Kosova"

PRISHTINË, 11 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Kalabri të Italisë, me ftesë të komunitetit të arbëreshëve të këtij rajoni. Atje Osmani është nderuar me çmimin "Gjergj Kastrioti" nga komuna e Frasnitës, për të cilin ka thënë se është mirënjohje për betejën historike të Kosovës për liri si dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Osmani ka thënë se arbëreshët janë shtyllë e kulturës dhe e

identitetit kombëtar. "Mirënjohëse për mikpritjen vëllezërve motrave arbëreshe. Për shekuj të tërë ata e kanë ruajtur identitetin kombëtar e gjuhësor, traditën, ritet e kulturën e të parëve të tyre. Ideja e rilindjes kombëtare dhe historia e heroit tonë nacional, Gjergj Kastriotit, e gjejnë burimin në tokën e arbëreshëve. Falënderoj komunën e Frasnitës për çmimin 'Gjergj Kastrioti'! Ky çmim është mirënjohje, para

së gjithash, për betejën historike të Kosovës për liri dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar", ka shkruar presidentja Osmani në "Facebook".

Ajo, gjithashtu, ka bërë me dije se në Arbëri, në praninë e shumë arbëreshëve të Frasnitës, është inauguruar sheshi i cili mban emrin "Kosova". "Nga sot kemi një copëz Kosove në zemër të Kalabrisë!", ka përfunduar Osmani.



Rubini: Kam kujtime të mira të punës me liderët e UÇK-së

PRISHTINË, 11 PRILL - Gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor është i cenueshëm ndaj dezinformatave ruse dhe kineze, por "një pjesë e madhe" e tyre vjen nga Serbia dhe ky është një "problem i madh që duhet të adresohet", thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", James Rubin, përgjegjës i Qendrës Globale të Angazhimit. Qendra është një organ i Departamentit Amerikan të

Shtetit, e krijuar për të ekspozuar dhe për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit. I pyetur se si e komenton hapjen e "Russia Today" - organizatë ndërkombëtare e lajmeve e kontrolluar nga shteti rus - në Serbi, Rubin thotë: "Ne nuk do të donim të shihnim 'Russia Today' ose media [të tjera] ruse kudo në botë. Duam që ato të mbyllën". Në intervistën dhënë "Radios

Evropa e Lirë", gjatë një qëndrimi të shkurtër në Prishtinë, Rubin flet edhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, themelues të së cilës po përballen aktualisht me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Rubini thotë se qëndrimi i ShBA-së për UÇK-në ka evoluar ndër vite.

Në ditët e para, kujton ai, ShBA-ja i ka dënuar "aktivitetet terroriste

të kryera nga grupet shqiptare", por me evoluimin e procesit të paqes, thotë se UÇK-ja është bërë qendër e atij procesi. "UÇK-ja luajti një rol vendimtar në marrëveshjet që u nënshkruan nga krerët e saj dhe në zbatimin e çmilitarizimit të premtuar. Unë kam kujtime të dashura të punës me liderët e tyre. Kjo nuk do të thotë se çdo gjë që ka ndodhur në atë kohë të luftës është diçka

që unë do ta mbështetja. Por, nuk mendoj se duhet ta rishkruajmë historinë për këtë temë", ka theksuar Rubin.

Gjatë luftës në Kosovë në fund të viteve 1990 Rubin ka qenë ndihmësekretar i shtetit amerikan. Kosova i ka ndarë në vitin 2013 Medaljen Presidenciale të Meritave për angazhimin e tij për çlirimin e Kosovës.



qeverisë, si e vlerësoni punën e opozitës? Ka qenë në nivel të detyrës gjatë këtyre dy vjetëve?

Lekaj: Kemi një opozitë konstruktive, por që në realitet nuk kemi pasur çfarë të kritikojmë, pasi për t'u kritikuar diçka qeveria duhet të punojë. Ne e kemi kritikuar mospunën e tyre dhe vendime të caktuara që kanë dëmtonuar interesat dhe mirëqenien e qytetarëve. Ne si AAK, me forcën që kemi, jemi munduar të jemi zë i qytetarëve. Kemi kërkuar shumë debate parlamentare, interpelanca parlamentare si dhe pyetje parlamentare. Kemi kërkuar largimin e TVSh-së për produktet bazë, largimin e TVSh-së për derivate, dhënien e Trustit për qytetarët e Kosovës, mosrritjen e tatimit në pronë, rritjen e pagës minimale, hyrjen

në fuqi të Ligjit të Pagave etj.

"Epoka e re": Javën e kaluar ka filluar gjykimi i drejtuesve kryesorë të UÇK-së. Z. Lekaj, si e keni parë këtë proces?

Lekaj: UÇK-ja është vlera më e madhe kombëtare e Kosovës. Çfarëdo gjykimi nuk mund ta njollojë vlerën dhe kontributin e pjesëtarëve dhe komandantëve të UÇK-së. Gjykata ka devijuar pak mënyrën e funksionimit dhe idenë mbi atë se çfarë është krijuar. Më pengon tendenca që krerët e UÇK-së të përgënjeshtrohen dhe etiketohen me të pavërteta.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet tuaja nga ky gjykim, i cili është thënë se do të jetë maratonik?

Lekaj: Presim drejtësi dhe liri për të gjykuarit, pasi po duket se kjo

është duke munguar. Presim dhe do të ishte mirë që edhe ndërkombëtarët të jenë të përfshirë në gjykimin e drejtë.

Rubini: Kam kujtime të mira të punës me liderët e UÇK-së

Prishtinë, 11 prill - Gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor është i cenueshëm ndaj dezinformatave ruse dhe kineze, por "një pjesë e madhe" e tyre vjen nga Serbia dhe ky është një "problem i madh që duhet të adresohet", thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", James Rubin, përgjegjës i Qendrës Globale të Angazhimit. Qendra është një organ i Departamentit Amerikan të Shtetit, e krijuar për të ekspozuar dhe për t'iu kundërvënë propagandës dhe dezinformimit.

I pyetur se si e komenton hapjen e "Russia Today" - organizatë ndërkombëtare e lajmeve e kontrolluar nga shteti rus - në Serbi, Rubin thotë: "Ne nuk do të donim të shihnim 'Russia Today' ose media [të tjera] ruse kudo në botë. Duam që ato të mbyllën".

Në intervistën dhënë "Radios Evropa e Lirë", gjatë një qëndrimi të shkurtër në Prishtinë, Rubin flet edhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, themelues të së cilës po përballen aktualisht me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Rubini thotë se qëndrimi i ShBA-së për UÇK-në ka evoluar ndër vite.

Në ditët e para, kujton ai, ShBA-ja i ka dënuar "aktivitetet terroriste të kryera nga grupet

shqiptare", por me evoluimin e procesit të paqes, thotë se UÇK-ja është bërë qendër e atij procesi. "UÇK-ja luajti një rol vendimtar në marrëveshjet që u nënshkruan nga krerët e saj dhe në zbatimin e çmilitarizimit të premtuar. Unë kam kujtime të dashura të punës me liderët e tyre. Kjo nuk do të thotë se çdo gjë që ka ndodhur në atë kohë të luftës është diçka që unë do ta mbështetja. Por, nuk mendoj se duhet ta rishkruajmë historinë për këtë temë", ka theksuar Rubin.

Gjatë luftës në Kosovë në fund të viteve 1990 Rubin ka qenë ndihmësekretar i shtetit amerikan. Kosova i ka ndarë në vitin 2013 Medaljen Presidenciale të Meritave për angazhimin e tij për çlirimin e Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës nuk është libër i shenjtë! Për t'u funksionalizuar shteti i Kosovës, ajo duhet të ndryshojë!



Shkruan: Valon MURATI

Kushtetuta e Kosovës e ka burimin tek Pakoja e Ahtisaarit, rrjedhimisht është një kompromis i madh i shqiptarëve të Kosovës në këmbim të pavarësisë së vendit. Kjo kushtetutë nuk buron nga vullneti popullor e as nuk është hartuar nga ekspertët tanë juridik e kushtetues. Thjesht është produkt i presionit ndërkombëtar që përmes pranimit të parimeve të Pakos së Ahtisaarit do të pranohemi

nga Serbia. Kur dëgjon në këtë ditë të flitet me një lloj shenjtërie për kushtetutën nuk e din njeriu se a po ndodh kjo për shkak të amnezisë politike kolektive, apo nën ndikimin e faktit se jemi po ashtu në mesin e dy festave fetare. Sigurisht përderisa është në fuqi Kushtetuta duhet të respektohet sepse kështu e kërkon parimi i sundimit të ligjit dhe rendi demokratik. Por po ashtu e vërtetat duhet të thuhet dhe të diskutohet gjerësisht. Kosova ka mungesë të funksionalitetit mu për shkak të aranzhimeve kushtetuese. Këtu flitet për kushtetutë qytetare e multietnike, ndërsa të gjitha zgjidhjet që ajo ka bërë sidomos për pakicën serbe janë etnike. Privilegjet të cilat iu kanë dhënë pakicës serbe kanë bërë që në vazhdimësi edhe nën ndikimin

e Beogradit zyrtar të shfrytëzohen për ta defunksionalizuar shtetin e Kosovës. Për më tepër në vend se të shfrytëzoheshin bisedimet me Serbinë për të krijuar rrethana për ndryshimet kushtetuese, përmes së cilave do të hiqeshin privilegjet bllokuese të përfaqësuesve politik të pakicës serbe, ne jemi dëshmitarë të një marrëveshjeje me Serbinë, e cila do ta rëndojë funksionalitetin e shtetit të Kosovës duke u shtuar peshë këtyre privilegjeve bllokuese kushtetuese përmes krijimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe si dhe një pozite të privilegjuar juridike për Kishën Ortodokse Serbe. Kështu tani do të ballafaqohemi me një trinom të mekanizmave tanë të brendshëm përmes së cilës Serbia do ta luftojë

funksionalitetin e republikës sonë.

Andaj detyrë primare e politikës sonë do të duhej të ishte të gjente rrugën për ta ndryshuar këtë kushtetutë e jo për ta betonizuar atë. Në vend të kësaj politika jonë dhe në rastin konkret, qeveria e prirë nga Albin Kurti, pa përjashtuar dëmet e shkaktuara edhe nga qeveritë paraprake, ia ka komplikuar edhe më tej jetën funksionimit shtetit të Kosovës. Bisedimet me Serbinë, kanë qenë mundësi për të hapur rrugën që Kosova të vendoste vetë se çfarë kushtetute do të ketë pa kufizimet e tanishme, por për momentin ky rast u lëshua. Në vend se të insistohej në reciprocitetin me Kosovën Lindore, u insistua që njohja të jetë në qendër të bisedimeve. Në vend se të insistohej në

idenë e ripërcaktimit të kufijve u insistua në integritet territorial. Në vend se të insistohej në zgjidhje që hapin rrugë ndryshimeve kushtetuese dhe funksionalitetit të shtetit të Kosovës u insistua në mos ndryshimin e saj. Pra gjithandëj insistime populliste kundër zgjidhjeve funksionale. Dhe në fund as njohja nuk erdhi dhe zgjidhjet që po vijnë e komplikojnë edhe më tej funksionalitetin e shtetit tonë. Sidoqoftë e vërteta duhet të thuhet: Kushtetutat nuk janë të shenjta! Për t'u funksionalizuar shteti i Kosovës, kjo kushtetutë duhet të ndryshojë! Rruga e vetme është rikthimi në tryezën e bisedimeve të projektit të vetëm të drejtë dhe që zgjidh problemin shqiptaro-serb në Ballkan atë të ripërcaktimit të kufijve.

Suspendohen katër zyrtarë policorë nën dyshimet për përfshirje në incidentin në veri



PRISHTINË, 11 PRILL - Policia e Kosovës i ka suspenduar katër zyrtarë policorë që dyshohet të ketë qenë të përfshirë në incidentin e 10 prillit në veri, ku është plagosur një banor i komunitetit serb. Disa orë më parë policia e ka mohuar përfshirjen në këtë rast. Disa medie në gjuhën serbe e kanë cituar një burrë të ketë thënë se vetëm pjesëtarë të Forcave Speciale të Policisë së Kosovës kanë qenë të pranishëm

në kohën kur personi në fjalë është plagosur tek Ura e Bistricës afër Zveçanit. "Bazuar në informacionet dhe dëshmitë e siguruar, janë marrë masa të suspendimit ndaj zyrtarit policor, pasi i njëjti nuk kishte raportuar lidhur me rastin dhe për përfshirjen e tij në rast, nga ku PK-ja kishte lëshuar njoftim se nuk ka qenë e përfshirë në shkëmbim apo gjuajtje me armë zjarri. Po ashtu, janë marrë masa të suspendimit edhe ndaj tre

zyrtarëve të tjerë të mundshëm të përfshirë në rast", është thënë në komunikatën e policisë. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, e ka dënuar më herët gjatë ditës atë që e ka konsideruar sulm të kryer nga Policia e Kosovës. "Ne po flasim për një burrë i cili ka tre fëmijë, po flasim për një shofer taksie. Në atë pikë ilegale të kontrollit Policia e Kosovës ndalon serbët çdo ditë dhe i ngacmon ata. Ne

kemi thënë disa herë se ata nuk kanë të drejtë të qëndrojnë në veri të Kosovës sepse është në kundërshtim me të gjitha marrëveshjet". Komunitet në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - janë të banuara me shumicë serbe. Ky rajon shpesh është vatër e tensioneve. Javën e kaluar një pjesëtar i komunitetit serb i është caktuar masa e paraburgimit prej një

muaji i cili dyshohet se ua ka vënë flakën veturave me targa RKS - Republika e Kosovës - në Zubin Potok, komunë me shumicë serbe në veri të Kosovës. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të hënën se incidentet në veri të Kosovës janë të orkestruara nga "struktura ilegale të mbështetura nga Beogradi", të cilat kanë për qëllim frikësimin dhe kanosjen e popullatës lokale serbe.

Shtrenjtimi i rrymës sinjalizon shtrenjtimin e prodhimeve

PRISHTINË, 11 PRILL - Për familjen katëranëtarëshe Makovci nga Millosheva - Komuna e Obiliqit - një rritje e re e çmimeve të prodhimeve do të ishte vështirë e përballeshme. “Nuk e di si do t’ia bënim... Do të blejmë gjëra më pak. Edhe ashtu janë shtrenjtë”, thotë kryefamiljarja Sherifja për “Radion Evropa e Lirë”.

Të ardhurat mujore në familjen e saj nuk kalojnë mbi 400 euro. I vetmi i punësuar është djali i saj, i cili punon shofer taksie. “Nëse para më shumë se një viti me 100 euro kam blerë disa nga produktet për një muaj, tani ato janë dyfish më shtrenjtë”, thotë Sherifja. “Me shumë vështirësi e mbyllim muajin. Kemi shpenzime jo vetëm për ushqime, por edhe për rrymën, ujin, mbeturinat e të tjera”, shprehet ajo.

Në Kosovë, si gjetiu në botë, inflacioni ka nisur të rritet në fund të vitit 2021 si pasojë e çrregullimeve në tregje që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit, ndërsa ka marrë hov nga shkurti i vitit 2022 kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës.


Kosova e ka mbyllur vitin 2022 me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind.

Por, një rritje të re të çmimeve janë duke e paralajmëruar përfaqësuesit e bizneseve dhe pronarët e kompanive prodhuese për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

Nga 1 prilli në Kosovë kanë hyrë në fuqi tarifatat e reja të energjisë elektrike me rritje prej 15.4% për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Kosto shtesë në prodhim

Kjo rritje rrit edhe kostot e prodhimit, thotë Sylejman Konushevc, pronar i një fabrike të



vajit në Kosovë. “Për momentin një litër vaj është 1.15 deri në 1.20 euro [çmimi i furnizimit]. Ne nuk mund ta ruajmë këtë çmim që e kemi tani me këtë rritje të rrymës që është bërë. Jam i sigurt që një litër vaj do të bëhet deri në 1.30 euro”, thotë Konushevc për “Radion Evropa e Lirë”.

Bindje të ngjashme shpreh edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. “Rritja e çmimit të energjisë elektrike nuk është lajm i mirë për bizneset. Kjo rritje është një kosto shtesë për prodhuesit vendorë dhe do të

ndikojë në shtrenjtimin e produkteve të tjera”, thotë Rafuna. Për më tepër, shton ai, rritja e tarifave të energjisë elektrike i vendos prodhuesit vendorë në një konkurrencë të padrejtë me kompanitë që eksportojnë në Kosovë. “Shtetet si Gjermania, Italia, Kroacia - qeveritë e tyre ua kanë subvencionuar bizneseve dallimin e çmimit të rritur të energjisë elektrike. Kjo, me automatizëm, nuk ka ndikuar te prodhuesi që të ketë kosto shtesë, që pastaj ta nxjerrë produktin me çmim më të lartë te konsumatori”,

thotë Rafuna për “Radion Evropa e Lirë”.

Prodhuesit në Kosovë vazhdimisht janë ankuar për konkurrencë të padrejtë, norma të larta të interesit dhe politika të pafavorshme fiskale.

“Radio Evropa e Lirë” ka raportuar më herët se për shkak të kësaj gjendjeje prodhimet vendore janë shpesh më të shtrenjta se ato që importohen.

Rafuna thotë se prodhuesit nuk kanë gjetur përkrahje nga institucionet e shtetit. “Ka munguar dialogu publiko-privat.

Ne jemi duke kërkuar që të vendoset një komunikim i drejtë dhe transparent mes bizneseve dhe qeverisë. Jemi duke kërkuar që para se të merret ndonjë vendim, të diskutohet me bizneset për t’i ditur efektet që mund t’i ketë një vendim përkatës”, thotë Rafuna.

Qeveria e Kosovës në të kaluarën ka ndërmarrë disa nisma, si “superpuna”, e cila i ka subvencionuar pronarët e kompanive, duke ua paguar pagën e punëtorit për gjashtë muaj në vlerë prej 264 eurosh.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është zotuar se qeveria e tij do të vazhdojë t’i mbështesë qytetarët. “Mbështetja jonë për qytetarë do të vazhdojë edhe pas vendimit të fundit të Zydrës së Rregullatorit të Energjisë [për shtrenjtimin e rrymës] ku, ndër të tjera, do t’i subvencionojmë familjet për konsum të energjisë deri në 800 kilovatë në muaj, kurse grupet e cenushme, siç janë familjet me asistencë sociale, do të kenë trajtim të veçantë”, ka thënë Kurti për gazetarët.

Nga shtatori i vitit të kaluar qeveria i ka subvencionuar të gjithë qytetarët që shpenzojnë më pak energji elektrike në muaj krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Secili konsumator që kursen së paku 5% të faturës përfiton subvencion sa dyfishi i përqindjes së kursyer. Ky subvencionim i qeverisë është ende në fuqi.

Sherifja tregon se faturën e fundit të energjisë elektrike e ka paguar 32 euro. Me shtrenjtimin prej 15.4-përqindësh ajo do t’i rritet për rreth 5 euro.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka paralajmëruar në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë” në janar, se inflacioni do të bjerë në pjesën e dytë të këtij viti.

Nxirren të gjithë minatorët e ngjuar në minierën e “Trepçës”

MITROVICË, 11 PRILL - Të gjithë minatorët që ishin të ngjuar në minierën e “Trepçës” një ditë më parë janë nxjerrë në sipërfaqe.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të “Trepçës”, Ibrahim Jonuzi, ka theksuar se në orët e para të mëngjesit të 10 prillit rreth 40 minatorë kanë mbetur të ngjuar në minierën e “Trepçës”, e cila gjendet në Stantërg, në afërsi të Mitrovicës. “Që nga ora 3 e mëngjesit minatorët kanë mbetur të ngjuar në horizontin 1 për shkak të një defekti të energjisë elektrike në ashensor”, ka deklaruar Jonuzi.


Ky horizont gjendet rreth 900 metra nën tokë.

Jonuzi ka theksuar se minatorët janë nxjerrë nga miniera përmes formës alternative, gjegjësisht përmes rrugës prej ku nxirren

mineralet, në formë mekanike dhe jo përmes ashensorit. Ai ka theksuar se minatorët që ishin të ngjuar, pas daljes, përveç shqetësimit të përgjithshëm, nuk kanë shprehur shqetësim shëndetësor. Në vendin e ngjarjes, sipas tij, kanë qenë të pranishëm pjesëtarët e Policisë së Kosovës, drejtuesit e “Trepçës”, ekipet e emergjencës dhe ekipet mobile për nxjerrjen e minatorëve të ngjuar. Megjithatë, asnjë nga udhëheqësit e “Trepçës” nuk u është përgjigjur thirrjeve telefonike të “Radios Evropa e Lirë” për t’i sqaruar arsyet e defektit në ashensor, që pamundësoi daljen në sipërfaqe të rreth 40 minatorëve, të cilët qëndruan të ngjuar në minierë për rreth 14 orë.



Çfarë është “Kompleksi i Edipit” dhe si reflektohet ai në marrëdhëniet e sotme



“Kompleksi i Edipit” është një koncept i prezantuar nga Sigmund Freud, pjesë e teorisë së tij të fazave psiko-seksuale të zhvillimit, që përshkruan një dëshirë për përfshirje seksuale me prindin e gjinisë së kundërt, dhe një ndjenjë xhelozie dhe rivaliteti me prindin e së njëjtës gjini.

Kjo fazë e zhvillimit të konfliktit të madh, supozohet se ndodh tek djemtë e moshës 3-5 vjeçare. Ky term është emërtuar sipas personazhit kryesor të tragjedisë “Edip mbret” nga Sofokliu. Në këtë tragjedi të lashtë greke, Edipi braktiset nga prindërit e tij që kur ishte foshnje.

Më vonë, në moshë madhore, ai bëhet mbret i Tebës dhe pa e ditur vret babanë e tij dhe martohet me nënën e tij. Analogu femëror i termit psiko-seksual është “Kompleksi i Elektrës”, i quajtur kështu sipas një figure tjetër mitologjike tragjike që ndihmoi në vrasjen e nënës së saj.

Edipal është termi i përgjithshëm për të dy komplekset. Shpeshherë këto teori interpretohen si prirje e burrave për të zgjedhur gra që ngjajnë si nënat e tyre, ndërsa gratë zgjedhin burra që u ngjajnë baballarëve të tyre. Të dy komplekset u cilësuan si të diskutueshme që kur u prezantuan për herë të parë në publik në fillim të shekullit XX-të.

Kritikët e Freudit thonë se ka shumë pak prova empirike që vërtetojnë vlefshmërinë e teorisë. Megjithatë, bazamenti i kësaj teorie konsiderohet ende si një gur-themeli i psikanalizës edhe sot e kësaj dite. Sipas Freudit, zhvillimi i personalitetit në fëmijëri zhvillohet gjatë 5 fazave psiko-seksuale: fazat orale, anale, fallike, latente dhe gjenitale.

Në çdo fazë, energjia seksuale shprehet në mënyra të ndryshme dhe përmes pjesëve të ndryshme të trupit. Secila prej këtyre fazave psiko-seksuale, shoqërohet me një konflikt të veçantë që duhet

zgjidhur për të kaluar me sukses dhe në mënyrë të shëndetshme në fazën tjetër.

Mënyra se si zgjidhet çdo konflikt, mund të përcaktojë personalitetin dhe marrëdhëniet e një personi në moshën madhore. Kompleksi Edipal, i prezantuar nga Freud në vitin 1899 në veprën e tij “Interpretimi i ëndrrave”, ndodh gjatë fazës fallike të zhvillimit (mosha 3-6 vjeç), një periudhë kur një fëmijë ndërgjegjësohet për dallimet anatomike seksuale, duke vënë në lëvizje konfliktin midis tërheqjes erotike, rivalitetit, xhelozisë dhe pakënaqësisë.

Në mënyrë të pandërgjegjshme, djali i vogël ndihet i lidhur seksualisht me nënën e tij. Zilia dhe xhelozia drejtohen ndaj babait, objekt i dashurisë dhe vëmendjes së nënës. Freudi besonte se një djalë i vogël është i dënuar të ndjekë dëshirat e tij, në të njëjtën mënyrë siç u dënua të bënte edhe Edipi i Sofokliut.

Ndjenjat armiqësore ndaj babait shkaktojnë frikën nga treshja, që është frika irracionale si ndëshkim për dëshirën ndaj nënës së tij. Për ta përballuar këtë ankth, i ri nis të identifikohet me babain, duke adoptuar qëndrime, karakteristika dhe vlera që babai i quan të tijat. Me fjalë të tjera, babai kalon nga rival në një model.

Pikërisht nëpërmjet këtij identifikimi me agresorin, djali zgjidh fazën fallike të zhvillimit psiko-seksual dhe e fiton “superegon” e tyre, një grup vlerash që e dominojnë mendjen e ndërgjegjshme të të rriturit. Në këtë proces, fëmija heq dorë më në fund nga ndjenjat seksuale ndaj nënës, duke i transferuar ato në figura të tjera femërore.

Por pasoja është se tejkalimi i Kompleksit të Edipit dhe reagimet që pasojnë, përfaqësojnë arritjen më të rëndësishme shoqërore të mendjes njerëzore, thotë Freudi. “Kompleksi i

Edipit është bërthama e neurozave dhe përbën pjesën thelbësore të përmbajtjes së tyre. Ai përfaqëson kulmin e seksualitetit infantil, i cili, me pasojat e tij, ushtron një ndikim vendimtar në seksualitetin e të rriturve” - theksonte më tej ai.

Zhvillimi analog psiko-seksual i Freudit për vajzat e vogla përfshin Kompleksin e Elektrës, që nis që në momentin që vajza kupton se i mungon penisin. Për këtë fajësohet nëna, dhe ajo bëhet objekt i inatit të vajzës. Në të njëjtën kohë, kjo e fundit zhvillon ndjenjat e dëshirës seksuale ndaj babait të saj.

Fakti që nëna merr dashuri nga babai, ndërsa ajo jo, bën që vajza të bëhet xheloze për nënën e saj, e cila tashmë shihet si rivale. Ashtu si djemtë e vegjël që duhet të kapërcejnë Kompleksin e Edipit, vajzat e vogla e zgjidhin këtë konflikt duke hequr dorë nga ndjenjat incestuale dhe rivaliteti, duke u identifikuar me nënën, dhe duke zhvilluar kësajsoj superegon.

Megjithatë, Freudi nuk ishte në gjendje të formonte një teori komplekse për zgjidhjen e konflikteve për Kompleksin e Elektrës, siç bëri për kompleksin e Edipit. Tek djemtë, zgjidhja e shtytjes Edipale motivohet nga frika e treshjes. Por Freudi nuk ishte në gjendje të gjente një nxitje po aq të fuqishme tek vajzat e vogla, edhe pse arsyetoi se ajo mund të motivohej nga shqetësimet për humbjen e dashurisë së prindërve të saj.

Edhe pse Kompleksi i Elektrës i atribuohet shpesh Freudit, ai u propozua në fakt nga nxënësi i tij, Karl Jung. Freudi arsyetoi se nëse konflikti që lind nga kompleksi Edipal nuk zgjidhet me sukses, kjo mund të shkaktojë “neuroza”, të cilat ai i përcaktoi si manifestime të materialit të pavetëdijshëm që prodhon ankth.

Djemtë mund të bëhen tepër

konkurrues me burrat e tjerë, duke projektuar rivalitetin e tyre të fshehtë me baballarët e tyre dhe mund të fiksohen pas nëna, duke kërkuar gra që i ngjajnë asaj. Ndërkohë, vajzat që nuk e mposhtin zilinë e mospasjes së organit mashkullor mund të zhvillojnë një kompleks mashkulloriteti kur të rriten, duke pasur probleme me intimitetin me burrat në moshë madhore.

Pra, ajo mund të përpiqet të rivalizojë burrat duke u bërë shumë agresive. Meshkujt me të cilët ajo ndërvepron ngushtë i ngjajnë shpesh babait të saj. Për më tepër, duke qenë se identifikimi i vajzave me nënat e tyre është më i dobët se i djemve me baballarët e tyre (të cilët kanë ankthin e treshjes), superegoja femërore është më e dobët dhe për rrjedhojë, identiteti i tyre si individë të veçantë, të pavarur është më pak i zhvilluar.

Freudi e shpjegoi teorisë e tij të kompleksit Edipal duke përdorur një rast të vetëm studimor, atë të “Hansit të Vogël”, djalit 5-vjeçar që kishte fobi ndaj kuajve. Rreth moshës 3-vjeçare, Hansi i vogël tregoi interes për penisin e tij por edhe të meshkujve të tjerë, përfshirë kafshët. Nëna e tij e alarmuar e kërcënoi se do t’ia priste penisin nëse ai nuk ndalonte së luajturi me të. Por pikërisht në atë kohë, ai zhvilloi një frikë të panatyrshme nga kuajt. Freudi arsyetoi se djali i vogël iu përgjigj kërcënimit të nënës së tij për treshje duke pasur frikë nga kuajt dhe organet e tyre gjenitale të mëdha.

Fobia u zbut kur Hansi nisi të ndërvepronte me kuajt, kur këtyre iu vendos mbi hundë një parzmorë e zezë që kishte qime të zeza rreth gojës, gjë që babai i tij sugjeroi se simbolizonte mustaqet e tij. Në interpretimin e Freudit, frika e Hansit nga kuajt përfaqësoje në mënyrë të pandërgjegjshme frikën e tij ndaj

babait të tij.

Megjithëse rasti i studimit të Hansit të Vogël ilustron në mënyrë të përsosur (dhe shumë të përshtatshme) teorisë e Freudit për Kompleksin e Edipit, ky është një rast i vetëm dhe i pamjaftueshëm për të përgjithësuar rezultatet për popullatën e gjerë.

Për më tepër Freudi e takoi Hansin vetëm një herë, dhe informacioni rreth tij i erdhi vetëm nga babai i Hansit, i cili ishte një admirues i hapur i punës së Freudit. Edhe nëse Hansi (emri i vërtetë i të cilit ishte Herbert Graf) vuanë vërtet nga një Kompleksi i Edipit, kjo nuk do të thotë se ai është universal siç pretendonte Freudi.

Për shembull, në vitin 1929, shkencëtari polako-britanik Bronislav Malinovski, që konsiderohet gjerësisht si babai i antropologjisë moderne, kreu një studim etnografik tashmë të famshëm në ishujt Trobriand në Oqeani, ku baballarët nuk janë aspak të përfshirë në disiplinimin e bijve të tyre.

Në këtë shoqëri, marrëdhënia midis babait dhe djalit ishte gjithmonë e mirë. Disiplinori në popullatat Trobriand është xhaxhai, që e hdh poshtë Kompleksin e Edipit. Edhe shkrimtarja psikoanalitike Klara Tompson kritikoi qëndrimin e Freudit ndaj grave, që sipas saj është i njëanshëm.

Ideja e Freudit se zilia e penisit ka bazë biologjike, mund të shpjegohet më mirë me zilinë e përgjithshme që kanë vajzat ndaj djemve, sepse shpeshherë i mungon i njëjti nivel lirie në moshën e re dhe mundësitë në moshë madhore. Dhe e gjitha kjo do të thotë se kompleksi Edipal i Freudit ka shumë të meta dhe në rastin më të mirë, mund të zbatohet për një përqindje të vogël të popullsisë së përgjithshme. / ZMEscience – bota.al

AJAZ EMINI - Ditar (XII)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Ky ishte fati jonë, sepse po theja të gjitha ligjet, po bëja kalimin ilegal pa dokumente si dhe inçizime mbrenda zonës së ndaluar kufitare. Si duket uniformat dhe kartelat tona ushtarake të Armatës Amerikane po e bëjnë të veten.

Në pjesën kufitare të Kosovës na qëlloi një polic i Kaçanikut i cili njihnte familjen e Shahadijes, pasi se na pa se kush ishim filloi të na pyes se si po kalonim, dhe kur na pa me uniformën e Ushtrisë Amerikane as që na kërkoi dokumentat e udhëtimit, as për ne e as për vajzat tona, përveçse që na përshëndeti dhe dëshiroi rrugë të mbarë.

Pasi kaluam kufirin shkuaam në Kaçanik në shtëpinë e vëllaut të Shahadijes, mikut Maksut Hoxha, aty ku tani ishte duke e shfrytëzuar shtëpinë djali i hallës së Shahadijes Haki Raka me familjen e tijë, i një familje të madhe intelektualësh. I lamë vajzat tona aty dhe ne vazhduam për në kampin ushtarak të Bondsteel'it. Kjo na ishte një ditë që nuk do të harrohet kurrë, dhe me shumë fate...

Në ditën e shtunë më 23 qershor 2001, derisa po udhëtoja me makinë prej Sojeve për në fshatin Çerkez të Kumanovës, menjëherë pas daljes nga qyteti i Shkupit në autostradën për në Kumanovë tek urat mbi autostradë, pashë shumë turmë njerëzish të mbledhur dhe kohë pas kohe po rrehnin shuplakë. Pasi kalova hotelin "Belevue", aty pashë edhe shumë makina. Disa qindra metra më tutje edhe unë dola në të djathtë nga rruga kryesore dhe parkova makinën anash dhe dola jashta makine për të parë se ç'po ndodhte. Disa qindra metra më tutje në fushën përballë me vreshta, kishin qenë disa tanka të renditura në formë harkore të cilat kohë pas kohe po gjuanin në mënyrë të sinkronizuar në drejtim të fshatit



Haraçinë i cili fshat shihej në anën e majtë të rrugës kryesore disa kilometra më tujtje rrënzë kodrinave të fshatit. Përveç sulmit me tanke që po sulmohej Haraçina, po sulmohej edhe me artileri të rëndë si dhe nga ajri sulmohej me dy helikopterët luftarak MI-24 që sapo i kishin marrë Maqedonia nga Ukraina. Çdo herë që gjuhej nga artileria apo helikopteri luftarak i forcave maqedone, e gjithë turma e atyre njerëzve kërcenin dhe rrehnin shuplakë nga gëzimi, kurse në anën tjetër pas çdo krisme shifej tymi dhe pluhuri ku qëllohej fshati Haraçinë. I gjithë fshati ishte në një pozitë të tillë që dukej sikurse të pozicionohej në shuplakën e dorës. Në atë vend qëndrova i ngujuar dhe i habitur për 10-15 minuta, dhe pastaj hyra në makinë dhe vazhdova rrugën në drejtim të Kumanovës. Gjatë rrugës po mendoja dhe po i bëja pyetje vetëvetes a thua si do të shpëtojnë pjesëtarët e UÇK-së dhe fshatarët e pa fajshëm që të gjitha këtyre granatimeve të çmendura të ushtrisë dhe policisë maqedone?

Në të arritur te motra në Çerkez i tregova Sabriut (dhëndrrit) se ç'po ndodhte, dhe menjëherë e dhezëm televizorin dhe pamë se në orën 15:00 i kishin ndërpre luftimet sepse në Hotelin "Belevue" të gjitha ato makina që i pashë, kishin qenë udhëheqja maqedone në pritje të Javier Solanës Përfaqësues i punëve të Jashtme të Bashkësisë Evropiane. Gjatë këtijë takimi ishte bërë edhe marrëveshja për ndërprerjen e të gjitha luftimeve, dhe ishin marrë veshë me envojin special të SHBA's Peter Feith, që pjesëtarët e UÇK's së bashku me të lënduarit dhe të vrarët, si dhe me armatimin e tyre të ndihmohen nga pjesëtarët e Armatës Amerikane që të tërhiqen në zonën e tyre të lirë, në fshatin Nikushtak! Evakuimi i pjesëtarëve të UÇK-së nga pjesëtarët e Armatës së SHBA-së filloi në të njëjtën ditë në orën 17:00, dhe mbrenda një kohe të shkurtër që të gjithë luftëtarët e UÇK-së u larguan nga fshati Haraçinë. Të nesërmen trupat maqedone hyjnë në



fshatin e boshaditur, pa asnjë pjesëtarë të UÇK-së. Në lidhje me këtë fenomen i kemi disa kontradikta ku thuhet se Kryetari maqedon Trajkovski kishte frigën se po fillonte një luftë civile në Maqedoni, ky ishte një verzion, por sipas tjetrit thuhet se Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së Lord George Robertson kishte thënë se sulmi maqedon kundër UÇK-së në fshatin Haraçinë ishte "çmenduri" dhe "krejtësisht i pa imagjinueshëm" dhe i kishte tërheqë vërejtjen se "Maqedonia ishte në prag të një lufte të përgjakshme civile." Meqenëse trupat e UÇK-së ishin të rrethuar në tre anët e fshatit, dhe tani nuk kishin as ushqim dhe as municion sa duhet, mendohej se ata tani për sulm do të përdorin mortajat 120 mm. dhe nga të cilat do të arriheshin caqe të sulmit si: aeroporti, rafineria, stacionet policore si dhe të gjitha pikat më vitale në Shkup, duke përfshi edhe Parlamentin e Maqedonisë. Ky ishte kërcënim të cilin ia kishte bërë qysh në fillim të luftimeve Komandant Hoxha, komandant për Forcat e UÇK-së në fshatin Haraçinë. Edhe kjo luftë e UÇK-së me shtetin maqedon, nuk ishte aspakë e barabartë. Për derisa forcat e UÇK-së kishin ushtarë nga popullata lokale me një numër të kufizuar të luftëtarëve, gjithashtu edhe të luftëtarëve të ardhur nga Kosova dhe Shqipëria. Thuhet se që të gjithë përbënin rreth 6.000-7.000 ushtarë, dhe me armatim të thjeshtë: Kallashnikov të vjetër dhe disa minahedhës. Kurse pala maqedone përbëhej prej ushtrisë së rregullt, rezervistëve ushtarak, policisë, luftëtarëve nga Ukraina, Serbia dhe Bullgaria e që numronin rreth 15.000-20.000 ushtarë dhe police që kishin armatim shumë më të sofistikuar si: artileri të ndryshme, tanke, autobllinda, automjete ushtarake dhe helikopter luftarak, si dhe kishin ndihma të mëdha në armatim dhe personel edhe nga

Bullgaria, Serbia, Ukraina dhe Turqia.

KTHIMI PAS TRE VJETËVE NË AMERIKË NGA KAMPI USHTARAK I ARMATËS SË SHBA's NË "BONDSTEEL" TË SOJEVËS NË KOSOVË

Gjatë të gjithë kësajë kohe sa ishim në Ballkan përjetuam shumë ndryshime! Pas bashkangjitjes tonë në Armatën Amerikane, kishim edhe qëllimin dhe planet kryesore që të mbetemi në Ballkan. Mirëpo duke i parë rrethanat në Kosovë dhe Maqedoni, na u desht që të anulohet planet dhe vendosëm që përsëri të kthehemi në shtëpinë tonë në SHBA-së prej nga kishim ardhur gati se para 3 vjetësh, në shtëpinë që ia kishim pas lënë në shfrytëzim refugjatëve tanë.

Shahadija me vajzat: Liridonën dhe Mimosën vendosëm që të ktheheshin më së voni deri në fillim të Shtatorit 2001, me qëllim që të arrijnë regjistrimin me kohë në shkollat përkatëse në Cleveland, Ohio të SHBA-së. Kurse për mua, vendosëm që të vazhdoja punën me Armatën Amerikane në Kosovë edhe për një kohë të pacaktuar, me qëllim që të shofim edhe më tej se si po rrjedhin gjërat në këto anë.

Shahadija me Liridonën dhe Mimosën u kthyen për në Amerikë gjatë ditëve të kobshme të tragjedisë së 11 Shtatorit, një rrugë e cila kishte qenë mjaftë e mundimshme! Më 11 Shtator 2001, atëherë 19 militantët e islamistëve ekstrem të quajtur Al-Queda, kidnapuan aeroplanët me udhëtarë. Dy prej tyre u përplasën me qëllim në katin e 88 të kullave binjake 110 katëshe mu në zemër të Manhatanit në qytetin e New York'ut për të shkaktuar sa më tepër viktima. I treti aeroplan u përplas në Pentagon jashtë Washingtonit, kurse i katërti aeroplan ra në Shanksville, në fushat e Pensilvanya's!

Gjatë këtijë sulmi patëm 2,996 viktima, me 19 terroristët e Al-Qaeda's dhe mëse 25,000 të lënduar!...

Ishte një ditë që do të mbetet në faqet e historisë së njerëzimit, ishte një ditë kur gjithëçka do të ndryshonte për gjithmonë! Tani edhe udhëtimit e sidomos ato me aeroplan do të ndryshojnë rëndësisht me kontrollet e tyre të pa numërta...

Me largimin e Shahadijes dhe vajzave nga Kosova, tani edhe për mua filluan shumë gjëra që të më bëhen monotone. Kështu që nga fundi i Shkurtit 2002 vendosa që edhe unë ta përfundojë misionin tim me Departmentin e Mbrojtjes së SHBA-s dhe të kthehem te



10 Prill 2004 Lakewood /SHBA, në takim me kryetarin e qytetit Thomas J. George kryesia e SHSHA Ilir Shyti, Ajaz Emini dhe Sako Satka

familja ime në Amerikë!
Nga fundi i Shkurtit 2002 kërkoja lejen e udhëtimit për kthim në SHBA nga zyreja e TRW, e cila ishte përgjegjëse për përkthyesit në Bondsteel të Kosovës. Kërkoja lejen sepse sipas kontratës që kishim, para kthimit në shtëpi na duhej që neve së paritë kthehemi në bazën e Armatës Amerikane në Fort Benning të Georgisë, prej nga u nisëm për në Shqipëri dhe Kosovë për të bërë nënshkrimin e prishjes së kontratës me to si dhe dorëzimin e pajisjeve ushtarake që na kishin dhënë. Gjithashtu duhe edhe kryerja e kontrollës mjekësore pas kthimit...

AKTIVITETET PAS KTHIMIT NË SHBA

Pas kthyerjes tonë në shtëpi, për një kohë të shkurtër nuk u morëm me asgjë, përveçse që po mundoheshim të stabilizoheshim në shtëpinë që kishim blerë para 3 vitesh.

Disa muaj më vonë, duke na parë se ende nuk kishim filluar asgjë, një i afërm i familjes tonë Sadat Inal mu lut që ta zëvendësoja atë në biznesin e tij që kishte të bënte me shitblerjen e makinave. Kërkoja për shkak se e kishte dasmën e motrës së tij në Turqi. E pranova lutjen e tij, dhe gjatë verës e zëvendësova atë për derisa të kthehej.

Pas kthimit të tij, Sadati mu lut që të vazhdoja të punoja edhe më tej me të përderisa të vendosi unë se me çka do të merrem! Meqenëse ende nuk kisha ndonjë plan konkret vazhdova këtë punë edhe për disa vite derisa vendosa që të hapi biznesin tim personal, po në të njëjtin profesion që po e bëja aty, në shitblerjen e automjeteve të ndryshme- profesion që edhe sot po zhvillojmë.

Pas disa vitesh hapa edhe dyqanin e dytë të të njëjtit biznes, disa kilometra më largë nga i pari po me të njëjtin emër: "ALB USA AUTO INC."

Në këtë biznes punësova edhe vajzën time Liridonën, e cila bëri punën e menaxheres për disa vite, derisa iu kyç shkollimit universitar si studente e rregullt në Cleveland State University, për çka i jemi shumë mirënjohës

dhe i dëshirojmë suksese në profesionin e sajë.

Përveçse punës në profesionin tregtarë makinash (Car Dealer), gjatë kësaj kohe vazhdova edhe më tej në profesionin edhe të përkthyesit, por tani jo si punë të rregullt pasi se kisha hapë biznesin tim.

Punën e përkthyesit e vazhdova edhe për Departmentin e Emigracionit, të cilët që kishin të bëjnë me disa lëndë të kriminelëve serb nga krimet e luftës në Bosne dhe Hercegovinë, - ish Jugosllavi! Detyra kryesore e Departmentit të Emigracionit ishte kapja e kriminelëve të krimeve të Srebrenicës, Potoçari dhe vendeve të tjera në Bosne dhe Hercegovinë ku ishin masakruar më shumë se 8,000 boshnjak musliman.

Këto maskra kishin ndodhur gjatë 11-22 Korrikut 1995, dhe pas luftës shumica e këtyre kriminelëve kishin emigru edhe në SHBA, për një jetë më të mirë, e që kishin shfrytëzuar rastin dhe kanë ardhë në Amerikë kinse edhe ata ishin viktima të asajë lufte. Por në realitet, ata vetë ishin kriminelët që kishin shkaktuar të gjitha ato krime mbi pupullin boshnjak musliman!

Në lidhje me krimet serbe nga Bosna dhe Hercegovina u angazhova dhe punova së bashku me oficerët e emigracionit në qytetin Tampa dhe Clearwater të shtetit të Floridës, si dhe në Chicago dhe Rockfort të shtetit të Illinois në SHBA.

Më vonë të njëjtën detyrë e bëmë edhe në qytetin e Detroit në Michigan, ku kësaj here në bashkëpunim kishim edhe gazetarin e mirënjohur, tani të ndjerë Sulejman Gashin dhe kolegun e përkthyesin e Gjeneralëve nga Bondsteel'i në Sojevë të Kosovës Mentor Hajdarin, me të cilët patëm mardhënie shumë të mira.

Në këto qytete, më vonë unë edhe u thirra disa herë nga prokuroria edhe si dëshmitarë i shtetit, që të dëshmojë në lidhje me përkthimet që kisha bërë me palët mbrojtëse, edhe para gjykatave ku po mbahej gjykimi i këtyre të akuzuarve serbë, të cilët më vonë pas luftës në Bosne dhe Hecegovinë ishin vendosur këtu në tokën e SHBA-s edhe me identitetet e rrejshme...



28 Nentor 2004 Cleveland /SHBA, me Presidentin e Shqipërisë Rexhep Meidani, Sylejman Çaushin dhe Ajnisha Hoxha.

DISA FJALË EDHE PËR AKTIVITETET E LËMISË KOMBËTARE

Me të kthyer prej Kosovës në Cleveland të Ohio's në SHBA, më erdhën në takim kolegët me të cilët kishim shoqëri dhe bashkëpunime dhe shumë më herët, në lidhjet e çështjes kombëtare dhe komunitetit shqiptarë këtu në rrethinën e qytetit të Cleveland'it. Në takim më erdhën dy shokët e kahmotshëm, Hasan Bakia nga Fieri edhe Burhan Vneshta nga Shkodra. Gjatë bisedës që të dy mu drejtuan, dhe donin që të më bindnin se do të ishte shumë mirë, që tani në zgjedhjet e reja të ardhshme që do të mbahen për Shoqatën Shqiptaro Amerikane të Cleveland'it, që edhe ti të jeshë konkurent për pozitën e kryetarit, pasi se ti mundë t'i përfaqësojsh më së miri të gjitha vilajetet shqiptare.

Në fillim propozimi i tyre mu duk si absurd edhe e kundërshtova në mënyrë kategorike, sepse në rrethin tonë në Cleveland shumica shqiptare që jemi, janë nga Republika e Shqipërisë, e ne që ishim nga Ish Jugosllavia, ishim në numër shumë shumë më të vogël. -U pajtova se dua të angazhohem, dhe të jemë sa më aktiv në të gjitha aktivitetet

kombëtare që do të kemi, por jo që të jem në pozitën e kryetarit të shoqatës. Pas disa javësh u caktua data e mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme për Shoqatën Shqiptaro Amerikane të Cleveland'it, ku mora pjesë edhe unë. Gjatë bisedës me kolegët që kisha për rreth, ma thyen mendjen sepse donin që edhe unë të kandidoja për pozitën e kryetarit të shoqatës, dhe unë në shenjë respekti të tyre, dhe me shpresë për të bërë diçka më mirë, pranova që edhe emri im të futet në kutinë e zgjedhjes për kryetar. Pas votimit të fshehtë që bëmë, edhe pse unë isha i pjesës së pakicës shqiptare nga Ish Jugosllavia, mu dha nderi që të fitojë shumicën e votave, edhe ashtu më zgjodhën mua për kryetar të ardhshëm, në vitet vijuese për Shoqatën Shqiptaro Amerikane të Cleveland'it. Sipas të gjitha gjasave, kolegët e mijë duket se kishin bërë kampanjë të fortë zgjedhore dhe mjaftë të suksesshme!

Ishte nderë për mua që të kisha besimin e shumicës, dhe që unë të jemë kryesuesi këtijë komuniteti shqiptarë buzë liqenit Erie të qytetit të Cleveland'it, në këtë pjesë të Amerikës, dhe gëzohem për sukseset që arritëm gjatë viteve në vazhdim me komunitetin shqiptar edhe të kësaj pjesë të Amerikës, në këtë qytet të Ohio's me rrethinë.

Sukseset më të mëdha të Shoqatës Shqiptaro Amerikane të Clevelandit të Ohio's që arritëm gjatë kësaj kohe, kuptohet se të gjitha këto suksese ishte bashkëpunimi ynë i ngushtë dhe i njerëzve shumë me vlerë që kishim, dhe kuptohet se pa ndihmën e të cilëve do të ishte i pa mundur i tërë ai sukses i arritur.

Gjatë kësaj kohe patëm shumë aktivistë, por tani po ju përmendi vetëm disa prej tyre siç janë: Arbereshja e famshme dhe këshilltarja e qytetit të Cleveland'it Dona Brady e cila ishte shtylla kryesore e shoqatës, pastaj Amsadori i Nderit të Shqipërisë dhe biznismeni i njohur Peter Cole, Hasan Bakia, Burhan Vneshta, Sako Satka, Anila Coniku, Adem Meta, Kujtim Dauti, Ilir Shyti, Valter Vajushi, Petrit Sulejmanaj, Abdurrahman

Thaçi, Feriz Ukshini, Ferat Amidi, Skender Demiri, edhe shumë e shumë të tjerë.

Me ndihmën e këtyre aktivistëve shumë të vlefshëm, arritëm një mori suksesesh: për herë të parë në historinë e shtetit të Ohio's, ne ishim që hapëm shkollën e parë në gjuhën shqipe, edhe atë me punën e mësuesve vullnetarë, gjithashtu morëm përsipër edhe financimin e klubit futbollistik "Eagels" (Shqiponja) të komunitetit shqiptarë për të cilin po kujdesej dhe po financohej nga Ferat Amidi.

Gjatë kësaj kohe filluam edhe me botimin e gazetës së parë dhe të vetme në gjuhën shqipe në të gjithë shtetin e Ohio's, të cilën e emëruam "Shqipja". Bëmë organizimet e shumta madhështore për manifestimin e festave të ndryshme kombëtare, dhe për Ditën e Flamurit Kombëtar të 28 Nëntorit më 2002, ku me ndihmën e biznismenit dhe atdhetarit të madh të çështjes shqiptare Sako Satka për këtë manifestim sollëm ish Presidentin e Republikës së Shqipërisë Prof. Dr. Rexhep Meidani së bashku me këshilltarin e tij Mentor Nazarko tani opinionist, si dhe disidentin dhe artistin e mirënjohur shqiptar, tani të ndjerin Maks Velo, për të cilin organizuam ekspozitën e tij private të pikturës këtu në ambientin e Kishës Ortodokse Shqiptare "E Premte", dhe në Cleveland State University (Univerzitetin Shtetëror të Cleveland'it).

Gjatë kësaj kohe bëmë edhe afrimin tonë me kryesitë e shoqatave dhe të komuniteteve tjera të Clevelandit, si dhe vëllazërimin dhe bashkëpunimin edhe me komunitetet shqiptare të Detroit dhe shumë qyteteve tjera në SHBA.

Nga Detroiti patëm bashkëpunim të shkëlqyer me botuesin e revistës "Kuvendi", dhe njëherit edhe organizatorin e letërsisë shqiptare në Amerikë zoteri Pjeter Jakun, Ambasadorin e Nderit të Shqipërisë për Michigan zotëri Ekrem Bardha, aktivistin e madh të çështjes shqiptare Luigj Gjokaj, Televizionin Shqiptar të Detroitit si dhe shumë institucione të tjera shqiptare në Detroit të Michigan'it.



25 Shkurt 2011 Detroit /SHBA, darka dhe takimi me Presidentin e Shqipërisë Bamir Topin me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar të Clevelandit

Bëmë bashkëpunim të shkëlqyer me udhëheqësinë e qyteteve të Cleveland'it dhe Lakewood'it, me të cilët patëm takime të pa numërta, si dhe prej të cilëve morëm një mori mirënjohjesh dhe lavdratash të ndryshme për punën dhe aktivitetet e Shoqatës Shqiptaro Amerikane ne Cleveland dhe rrethinë që po bënim!

Gjatë kësaj kohe, me ndihmën e Ambasadorit të Nderit të Shqipërisë për Ohio, biznesmenin e njohur shqiptar Peter Cole, arritëm që të vendosim edhe zyrën e Shoqatës Shqiptaro Amerikane të Cleveland'it në Kishen Ortodokse Shqiptare "E Premte" në Cleveland, në objektin ku para

shumë vitesh kishte ligjeruar edhe kleriku dhe themeluesi i pare i Kishes Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Amerikë që e themeloi më 1908 në Boston të Massachusetts, linguisti, diplomati, i madhi i letërisë shqipe: Fan Stilian Noli. Komuniteti ortodoks shqiptar i kësaj kisha ishin shumica e moshës së shtyer, dhe shumica prej tyre ishin pjesë e emigracioneve të para dhe shumë të hershëm në Amerikë, të cilët në fillim me paraqitjen tonë ishin mjaftë skeptik, edhe kishin një lloj hezitimi që të na jepnin çelësat e objektit të kishës që edhe ne të shfrytëzonim të njëjtin objekt për interesat e Shoqatës Shqiptaro Amerikane të



2020 Cleveland /SHBA, Ajaz dhe Shadije Emini, Kathryn Ryan, Qemo, Dona Brady dhe Adem Meta në Kopshtin Kulturor Shqiptar "Nënë Tereza".



North Olmstead /SHBA, Kumanovarët në darkë me gazetarin Isen Saliu dhe Amir Idrizin të gazetës "Lajm" te Shkupit.



2001 Cleveland /SHBA, takimi ne "Eagle" cafe me komunitetin shqiptarë

Cleveland'it. Mirëpo për shkak të besimit që kishte ndaj nesh biznesmeni Peter Cole, mu lejua që edhe unë të mbaja çelësin e objektit të kishës, edhe na u lejua që edhe në atë objekt të mbanim mbledhjet e shoqatës tonë!

Gjatë kësaj kohe patëm mardhënie shumë të mira edhe me diplomacinë shqiptare në Shqipëri dhe këtu në Amerikë, e sidomos me Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Washington D.C. që ndodhej gjatë kësaj kohe, zotërinë Fatos Tarifa, nga të cilët patëm edhe shumë vizita këtu në lokalet e shoqatës tonë në Cleveland.

Gjatë kësaj kohe Shoqata Shqiptaro Amerikane e Cleveland'it, ishte edhe ndihma kryesore e emigrantëve të rinjë shqiptarë që po vinin, si dhe të posa ardhurit në këtë qytet buzë Liqenit Erie, për ndihmën e të cilëve i faleminderohemi gjithashtu edhe Diocezës Katolike të Clevelandit, e në veçanti motrës së nderit Kathryn O'Ryan, e cila në mirënjohje të Nënë Terezës që kishte patur fat ta takojë gjatë vizitës së sajë në SHBA, dhe profesionit që kishte zgjedhur, ajo ishte shumë e përkushtuar që të na dalë në ndihmë kurdoherë që kishim nevojë në këtë rreth. Dioceza Katolike e Cleveland'it na

ndihmoi për të posa ardhurit shqiptarë: me veshëmbathje, shtroje dhe mobile falas.

Ne pjestarët e kësaj shoqate, gjatë kësaj kohe organizuam dhe morëm pjesë edhe në një numër të madh të protestave shqiptare që u mbajtën në Cleveland si dhe qytetet tjera të SHBA's, për të drejtat e Shqiptarëve në të gjithë Ballkanin.

Gjatë Tetorit 2003 bëmë edhe lobimin për mos shtyrjen e statusit, si dhe shpalljen dhe pranimin e Shtetit të Kosovës nga SHBA'ja, duke vepru në mënyrë masovike me shtypjen e mëse 1,500 kartë postale në adresë të Presidentit të SHBA's, zotëri George W. Bush'it, të plotësuar nga shumica e komunitetit shqiptarë në Ohio, si dhe shoqëritë amerikane që kishim për rreth, me porosinë e shkruar: "JU LUTEMI, NJIHE PAVARËSINË E SHTETIT TË KOSOVËS!"

Më vonë gjatë vizitës së parë të Presidentit George Bush, si një president i parë Amerikan që po i bënte vizitë Republikës së Shqipërisë, më 10 Qershor 2007, kur para një turme shumë të madhe të popullatës shqiptare që ishte mbledhur në Tiranë, ai e tha haptas para tyre: "Mjaft, është mjaft! Kosova është e pavarur!"

Komuniteti shqiptar i Clevelandit me vetë kontributin e tyre, por edhe me ndihmën e shtetit amë të Shqipërisë, gjithashtu arritëm të bëjmë edhe statujën madhështore të Nënë Terezës në Kopshtin Kulturor shqiptar të Clevelandit, e që për inaugurimin e së cilës patëm për mysafir nderi edhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë Bujar Nishanin...

MIRËNJOHJET DHE MEDALJET PREJ AKTIVITETEVE TË NDRYSHME

Për punën dhe aktivitet tona personale morëm shumë letra nga senator dhe kongresmen amerikan, mu dha Mirënjohja nga Kongresi Amerikan "CERTIFICATE of SPECIAL CONGRESSIONAL RECOGNITION"

N" më 28 nëntor 2010.

Gjatë punës tonë me Shahadijen, morëm shumë letra mirënjohëse dhe medale edhe prej komandës ushtarake me të cilët bashkëpunuam në Armatën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë viteve 1999- 2002, disa prej të cilave që na u ndanë janë këto:

Medalja "KOSOVO CAMPAIGN / IN DEFENSE OF HUMANITY" dhe Medalja "NATO / IN SERVICE OF PEACE AND FREEDOM" të dedikuara kryesisht për pjesëtarët e OPERATION ALLIED FORCE, Medalja "OPERATION JOINT GUARDIAN - KOSOVO", "LINGUIST*HONORING OUR BEST *QUALITY PERFORMANCE" nga TRW, monedhat ushtarake si JAG-US ARMY, 10th SPECIAL FORCES GROUP, TASK FORCE FALCON-KOSOVO, US MARINE dhe shumë të tjera.

DISA NGA SHKRIMET NË MEDIUMET E NDRYSHME RRETH AKTIVITETEVE TONA

- Associated Press "Albanian-American respond to a call to duty / April 1999 -NPR /National Public Radio, emisioni "All Things Considered" by; Noah Adams /March 1999-- "Kuvendi" Revista e përmuajshme kombëtare në Detroit / Dhjetor 2005 nga Pjetër Jaku

- Libri "Shqiptarët e Detroitit" nga Pjetër Jaku

- "Illyria" Gazeta Shqiptaro Amerikane e Nju Jorkut /Nga Anila Coniku

- Greater Cleveland Mosaic /The International Community Council /Albania

- Gazeta "Lajm" Shkup /Nga Isen Saliu /14 Gusht 2017

- Lajm Tv. /Nga Isen Saliu

- "Presheva Jonë" /Nga gazetari në OKB, Nefail Maliqi /02 Jan.2020

- News Tv. /Nga Reshat Ibrahim

- "Bota Sot" / Nga gazetari në OKB, Nefail Maliqi /03 Jan. 2020

- "Bardhësitë e Atdheut" Enciklopedia e dëshmorëve dhe luftëtarëve të UÇK's (1997-2002) / Nga Afrim Mustafa /18 Shtator 2020

- Gazeta "Shqiptari" /24 nëntor 2020

- Lajmpress.org. /24 nëntor 2020 etj.



BIBLIOGRAFIA

Ditari im Personal /1999-2002	/Macedonia /1999	/RAND
Muharrem Shaljani /Dosja	Highlights of Operation Allied Force /1999 NATO Press Releases /1999	European Contributions to Operation Allied Force /Air Force RAND
The Soldier's Handbook /Albania /Yugoslavia	The Crises in Kosovo /1999	Kosovo Situation Reports
	Wikipedia /NATO Bombing of Yugoslavia Operation Allied Force /Lesson for the future	NATO Speech: Operation Allied Force Noel Malcolm /Kosova UNHCR Kosovo /1999



Kujtime egotiste



**MARI HENRI BEL
(STENDAL)**

(përktheu nga origjinali (nga frëngjishtja) Verjon Fasho)
[për herë të parë në gjuhën shqipe botuar në revistën "Akademia"]
(kapitujt e mëparshëm, në numrat pararendës të revistës)

KAPITULLI I KATËRT

Ja një tjetër shoqëri, e cila është krejt ndryshe nga ajo e kapitullit të mëparshëm.

Më 1817 njeriu që kam admiruar më së shumti për shkrimet e veta, i vetmi që bëri revolucion tek unë, zoti konti de Trasi, më erdhi për vizitë në Hotel d'Itali, në sheshin Favar. Kurrë më parë nuk kam mbetur aq i habitur. Prej dymbëdhjetë vjetësh e kam admiruar Ideologjinë e këtij burri, e cila një ditë do të jetë fort e shquar. I kishin lënë poshtë derës një ekzemplar të Historia e pikturës në Itali.

Ndenji një orë me mua. E admiroja aq shumë saqë, sipas gjasave, e humba fare toruan nga tepria e kësaj dashurie. Kurrë s'kam dëshiruar të jem më i zgjuar apo më i këndshëm sa ky person. Gjatë asaj kohe iu qasa kësaj inteligjence aq të gjerë, e sodisja i mahnitur, i lypja dituri. Nga ana tjetër, ende s'e dija në zotëroja sadopak mençuri.

Ky improvizim i një mendjeje të pastër më erdhi vetëm më 1827. Zoti Destyt de Trasi, Per i Francës, anëtar i Akademisë, ishte një plakush imcak, shumë babaxhan, me pamje elegante e krejt të veçantë. Me pretekstin se i është bodësuar të parit, zakonisht mban një kasketë të gjelbër strehëgjere. E kam parë të pranohet në Akademi nga konti de Sezhyr, i cili i rrëfeu një kosh me marrëzira në emër të despotizmit perandorak. Kjo, nëse nuk gaboj, ngjau më 1811[1]. Megjithatë isha fort i lidhur me oborrin perandorak, m'u neverit fund e krye. "Po biem kryekëput në barbarinë ushtarake. Po bëhem gjenerali Gros[2]", - thosha me vete.

Zoti de Trasi kurrë s'ka dashur që t'i bënin portret. Më duket se i përngjante papës Korsini Klement, siç e hasim në tablonë e kishës San-Mari-Mazhër, kur futesh në të majtë. Sjellja e tij është e përkryer, kur nuk e ka kapluar ai humor i zi aq i kobshëm. Ia kuptova karakterin vetëm më 1822. Është një donzhuan i moçëm - pothuajse gjithçka e sillte në qejf. Për shembull, në sallonin e tij, zoti Lafajet[3] dukej më i fisëm se ai (madje edhe më 1821). Ndër të tjera, zotërinjtë francezë s'e kanë vlerësuar kurrë Ideologjinë dhe

Logjikën. Zoti de Trasi u thirr në Akademi nga këta gojëtarë të mykur vetëm si autor i një gramatike të mirë dhe sërish i fyer rëndë nga ai servili Sezhyr, baba i një biri edhe më servil (zoti Filip, i cili shkroi fatkeqësitë tona të Rusisë për një dekoratë nga Luigji XVIII). Ky i poshtri Filip de Sezhyr do të më shërbejë si shembull për personazhin që urrej më së shumti në mbarë Parisin: kallëpi i qeveritarit besnik i nderuar në gjithçka, përveçse në hapat vendimtarë që njeriu hedh në jetë[4].

Kohët e fundit ky farë Filipi luajti kundrejt ministrit Kazimir Perié (shih Debatet, maj 1832) rolin që i erdhi më për mbarë për t'i fituar favorët e këtij Napoleoni, të cilin më vonë e braktisi aq paturpësisht dhe, më pas, favorët e Luigjit XVIII i cili kënaqej me kësi njerëzish fundërrina. Ai i kuptonte më së miri poshtërsitë e tyre, ua kujtonte me fjalë aq mikluose në çastet kur ata bënin diçka të fisme. Ndoshta miku i Favrait[5], i cili priste lajmin e dënimit të tij me vdekje për t'i thënë më pas ndonjërit prej miqve: "Mbushnani kupat me verë!" do ta kuptonte plotësisht këtë personazh. Ai ishte nga ata burra që e pranonte se ishte një ndyrësirë dhe arrinte të qeshte me ndyrësinë e vet.

E di fort mirë që termi ndyrësi s'e ka efektin e duhur, por këtë lapërdharin Filip Sezhyr e kam pasur halë në sy. E dua dhe e çmoj njëqind herë më shumë një burgaxhi të thjeshtë, apo një vrasës të rëndomtë i cili ka rënë pre e një çasti dobësie dhe që, për më tepër, do të vdiste nga...[6], si zakonisht. Më 1826 apo '28, ky Filipi i dashur ishte i zënë mat duke mbarsur me fëmijë një vejuhë milionere të cilën sapo e kishte joshur dhe orvatej ta merrte për grua (zonjën G..., vejuhë e një parie të Francës). Me raste kisha darkuar bashkë me gjeneral Filip de Sezhyrin në tryezën e perandorit. Asokohe Filipi broçkolliste vetëm për trembëdhjetë plagët e tij të marra në përlëshje, sepse njëkohësisht ishte edhe shtazë sypatrembur!

Në Rusi, në këtë vend gjysmë të civilizuar, do të ishte bërë hero i madh. Në Francë njerëzia zuri ta kuptojë poshtërsinë e tij. Zonjat Garnet (në rrugën Dypo, nr. 12) dëshironin të më paraqitnin te vëllai i tij, fqinj i tyre (nr. 14), nëse s'gaboj, gjë që e kam refuzuar disa herë për shkak të këtij historiani të fëlliqur të fushatës së Rusisë.

Ky konti de Sezhyr, udhëheqësi suprem i ceremonive në Shën Klod më 1811, po vdiste nga pikëllimi që nuk zotëronte titullin dukë. Në sytë e tij kjo qe më tepër se fatkeqësi, diçka fort e pahijshme. Të gjitha mendimet e tij ishin gjeputa, por ai kishte shumë të tilla dhe, mbi çdo gjë. Te të gjithë ai nuk shquante veçse rëndomësi, por me ç'elegancë të pashoqe i shprehte ai ndjenjat vetjake.

Më pëlqente ajo dashuri aq e përkushtuar e së shoqes për këtë burrë të gjorë. Ndër të tjera, teksa i flisja më dukej sikur kisha

të bëja me një krijesë lilipute. Zotin de Sezhyr, udhëheqës suprem i ceremonive nga 1810-a deri më 1814, e kam takuar në kabinetin e ministrave të Napoleonit, e nuk e pashë më që pas rënies së këtij burri të madh, për të cilin ai qe veç një hallkë e dobët dhe një fatkeqësi më shumë.

Edhe fisnikët e Danzosë[7] në oborrin e perandorit, (e nuk ishin të paktë, për shembull, miku im baroni Marsiel Dary) edhe këta njerëz pra nuk e mbajtën dot të qeshurit në ceremoninë e sajuar nga konti de Sezhyr gjatë martesës së Napoleonit me Mari-Luizën e Austrisë, e sidomos në atë të takimit të parë mes tyre. Edhe pse i dashuruar me uniformën e tij të re mbretërore, Napoleoni nuk mundi ta përmbante veten, por zuri të qeshte me të bashkë me Dyrokun. Ky i fundit ma rrëfeu këtë ngjarje me gojën e tij. Besoj se asgjë nuk u krye nga i labirint vogëlsish të lodhshme. Nëse do të kisha këtu shkresat e mia të Parisit, do t'ia bashkoja atë program këtij shkrimi me profkat e jetës time.

Më 1832 psherëtij duke thënë me vete: "Ja deri në ç'masë rëndomësia parisiane e kishte vënë përposh një italian: Napoleonin!"

Po ku isha unë në gjithë këtë rropull? O Zot, sa për keq mori kjo frazë!

Zoti de Sezhyr, kryesisht në Këshillin e Shtetit, gëzonte jo pak madhështi. Ky këshill ishte me reputacion të lartë. Më 1810 ai nuk ishte thjesht një turmë pedantësh (si më 1832), apo një turmë Kuzësh[8], Zhakminosh[9], turmë...[10] e të tjera më të paqarta.

Duke përjashtuar peshat e rënda, armiqtë e tij të çartur, Napoleoni kishte mbledhur në këshillin e vet pesëdhjetë francezët më pak budallenj të mundshëm. Kishte disa seksione. Ndonjëherë, seksioni i luftës (ku unë isha rishtar nën kujdesin e të admirueshmit Guvion de Sën-Kyr[11]), kishte të bënte me seksionin e brendshëm të cilin zoti de Sezhyr e kryesonte me raste, nuk e di se si, por besoj gjatë mungesës së Renjosë[12] të fuqishëm (konti de Sën-Zhand'Anzheli), kur e kapte sëmundja rrallë.

Në çështje të vështira, për shembull, ajo e ngritjes së rojeve të nderit në Piemont, një raportues i vogël i të cilëve isha dhe vetë, eleganti dhe i përkryer de Sezhyr, duke mos gjetur dot asnjë ide, troshiste karrigen e tij, por e bënte me një lëvizje jashtëzakonisht qesharake, duke e zaptuar mes kofshëve të hapura. Pasi qeshja me pafuqinë e tij, thosha me vete: "Por, mos jam unë ai që gabohem vallë? Ky ishte ambasadori i shquar pranë Katerinës së Madhe, i cili i rrëmbeu penën ambasadorit të Anglisë[13]. Është historiani i Uilliamit II apo III (nuk më kujtohet më se cili, dashnori i Lishtënosë për të cilën Benzhamin Konstant bënte duel)".

Në rini vuaja nga sindroma e të

respektuarit me tepri. Kur imaginata ime fokusohet te ndokush, qëndroja si guhak përpara tij: i adhuroja të metat e tij. Por ana qesharake e zotit de Sezhyr, duke udhëhequr Napoleonin ishte, me sa dukej, shumë e fortë për leshtësinë time.

Përveç kësaj, për kontin de Sezhyr, mjeshtër madhor i ceremonive (krejt ndryshe nga Filip), mund t'i paramendonim të gjitha sjelljet më delikate, me faktorin vajzë kuptohet, duke i çuar ato deri në heroizëm. Ai përdorte edhe fjalë të përzgjedhura me plot hijeshi, por s'lipsej të ngriheshin përtej masës lilipute të ideve të tij. Kam bërë gabimin më të madh që nuk u mora sa duhej me këtë plakush të dashur nga 1821-shi deri më 1830. Besoj se u shua njëherësh me të shoqen e nderuar. Por ja që isha budalla. Neveria që ndieja për poshtërsinë më qe bërë si pasion më vete në vend se të argëtohesha sikundër bëj sot me disa çështje të oborrit të...[14].

Konti de Sezhyr, gjatë kthimit tim nga Anglia, më 1817, më kishte mbuluar me lëvdata për Romë, Napoli dhe Firence, broshurë që ia kisha lënë pas portës. Nga thellësia e zemrës, nga pikëpamja morale, gjithmonë e kam urreyer Parisin. Për t'i pëlqyer këtij të fundit, duhej të ishte, ashtu si de Sezhyri, mjeshtër i madh.

Nga pikëpamja fizike Parisi nuk më ka pëlqyer kurrë. Edhe më herët, më 1803, e urreja meqë s'ishte i rrethuar nga male. Malet e vendit tim (Dofinesë), dëshmitare të pështjellimeve të zemrës, gjatë gjashtëmbëdhjetë vjetëve të para të jetës sime, më kishin dhënë atje një zakon nga i cili nuk mund të lirohesha kurrë. Parisin nisa ta kem për zemër pas 28 korrikut 1830. Edhe gjatë Urdhëresave, në njëmbëdhjetë të darkës, në shtëpinë e kontit Réal[15] tallesha me guxim të parisienëve dhe rezistencën që pritej prej tyre. Besoj se ky burrë kaq babaxhan dhe e bija e tij heroike, zonja baroneshë Lakyé, ende nuk ma kanë falur këtë trill timin.

Sot për Parisin kam konsideratë. E pranoj që për guxim ai duhet të renditet në krye ashtu si dhe për gatimet, gjithashtu edhe për mençurinë që ka. Nuk është se më josh dhe aq për këtë të fundit. Gjithmonë më është dukur se ka njëfarë komedie në virtytin e tij. Të rinjtë e lindur në Paris nga etër provincialë, e në atë zellin burrëror të të bërit pasuri, më dukeshin si ato qeniet e yjzuar, të kujdesshme vetëm për pamjen e jashtme të veshjes së tyre, për shijen e hollë rreth kapelave të tyre ngjyrë gri, për kravatat e vendosura mirë, njësoj si zonjat Febyrja, Violetlë-Dyk etj. Nuk mund ta imagjinoj një burrë pa pakëz zell prej mashkulli, pa qëndrueshmëri dhe thellësi në idetë e tij etj. Të gjitha këto janë po aq të rralla në Paris sa dhe veprimet e pasjellshme apo të

ashpra makar.

Por, këtë kapitull më duhet ta mbyll këtu. Duke u përpjekur të mos gënjej dhe të mos i fsheh të metat e mia, jam detyruar t'i shkruaj këto kujtime në njëzet faqe për çdo seancë, si të qe letërkëmbim. Pas ikjes sime nga kjo botë, ky dorëshkrim origjinal do të shtypet në kartë. Mbase këso udhe do të arrij drejt vërtetësisë, por më duhet t'i kërkoj lexuesit (ky i fundit mund të ketë lindur sa ora në ndonjë shtëpi fqinje) të më falë për çorollepjet e shpeshta jashtë temës.

[1] Zoti de Tresu u pranua në Akademi më 1808. Ai zëvendësonte Kabanis-in.

[2] Ky gjeneral, të cilin e shihja në sallonin e konteshës Dary, ishte një ndër kordhëtarët më teveqel të gardës perandorake dhe jo vetëm kaq. Kishte një theks të trashë prej fshatari, kryesisht brutal për të fshikulluar francezët, armiqtë e personit (perandorit) i cili e mbante me bukë. Ky personazh u bë macja ime e zezë aq sa, në mbrëmjen e betejës së Moskovës, duke parë ca hapa më tutje tentat e nja dy a tri gjeneralëve të gardës, atij i shpëtoi e tha: "Ata janë ca të pacipë... (fjalë e pakuptueshme)! Fjalë të cilat mezi m'i rroku veshi". (Shënim i H. Beilit).

[3] Marie-Joseph Paul Yves Roch Gilettr du Motier, Marquis de Lafayette (1757-1834), fisnik i shquar dhe ushtarak i madh francez, i cili u bë pjesë e Luftës Revolucionare Amerikane si udhëheqës suprem trupash në disa beteja. (Shënim i përkthyesit).

[4] Zoti Ror mendoi se konti de Sezhyr paskësh pasur marrëdhënie të këndshme me Bejlin? Shih Sthendal, f. 41.

[5] Thomas de Mahy, markezi de Favras (1744-1790), fisnik francez, mbështetës i burbonëve gjatë Revolucionit Francez. Mendohet se ra dëshmor për çështjen ruajaliste, duke e çuar në satër për pretekstin se po komplotonte në dëm të bashkëqytetarëve të tij. Në fakt, ra pre e një gracke të ngritur nga miqtë më të afërt (ndër ta supozohet të jetë edhe Lafajeti), por gjithë këtë e prit me burrëri. Mbahet mend për fjalët e fundit para ekzekutimit: "Vura re se në urdhëresën e dënimit tim me vdekje janë bërë nja tri gabime drejtshkrimore". (Shënim i përkthyesit).

[6] E mbetur bosh në dorëshkrim.

[7] Dangeau, komunë e Francës, pjesë e departamentit Eure-et-Loir, nga ku dolën shumë fisnikë, burra shteti, ushtarakë dhe klerikë të shquar. (Shënim i përkthyesit).

[8] Victor Cousin (1792-1867), filozof spiritualist, prijës i shkollës eklektike. (Shënim i përkthyesit).

[9] Jean Franchois Jacqueminot (1787-1865), gjeneral i shquar francez. (Shënim i përkthyesit).

[10] E mbetur bosh në dorëshkrim.

[11] Laurent de Gouvion Saint-Cyr (1764-1830), komandant i lartë francez gjatë Revolucionit Francez dhe në Luftërat Napoleoniane. (Shënim i përkthyesit).

[12] Michel Louis Etienne Regnaud (1761-1819), politikan i shquar francez. (Shënim i përkthyesit).

[13] Zoti de Sezhyr pati shumë sukses në oborrin mbretëror të Rusisë, sukses diplomatik dhe sukses letrar.

[14] Të Romës, padyshim.

[15] Pierre-Franchois, comte Réal (1757-1834), gjyqtar dhe politikan i shquar francez. (Shënim i përkthyesit).

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



KBF Bashkimi shpallet kampion i Kosovës

PRIZREN, 11 PRILL - Bashkimi është kampion i Kosovës. Prizrenaset kanë shënuar fitoren në ndeshjen me Prishtinën me rezultat 78:64 (22:16, 19:8, 24:16, 13:14), ku kjo fitore e shpall njëherësh Bashkimin kampion në

Superligën e Femrave për edicionin 2022/2023. Medaljet e argjendta të vajzat e Prishtinës i ndau Drejtori i Sportit në Komunën e Prishtinës, Granit Rugova dhe Komesari i Garave në FBK Faton Kurshumlija kurse

medaljet e arit i ndau Anëtarë i Bordit të FBK-së Rrahman Përteshi dhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku. Trofeun e MVP-së të lojtarja më e mirë Khadija Brown Haywood, e ndau Sekretarja e Përgjithshme e

FBK-së, Elvira Dushku, kurse Kupën e kapitenia Aulona Muhadri e dorëzoi Kryetari Fetahu. Këtë vit KBF Bashkimi ka fituar gjithashtu edhe Kupën në Final 8 në Rahovec, ku pati triumfuar ndaj Prishtinës.



City deklason Bayernin, Interi triumfon në Lisbonë

MANCHESTER, 11 PRILL - Dy ndeshjet e para çerekfinale të Ligës së Kampionëve dhuruan spektakël. Manchester City tregoi se është një nga pretendentët e kompeticionit. Skuadra nga Manchesteri mundi pastër 3-0 një rival si Bayern Munchen, në një sfidë emocionuese të luajtur në "Etihad Stadium". Në minutën e 22-të, Erling Haaland shfaqet mrekullisht para portës së Sommer, e majta e tij nuk ishte e fortë, duke u neutralizuar menjëherë nga "gardiani" i kampionëve të Gjermanisë. Pak më pas, "Qytetarët" do finalizonin me sukses një aksion. Do ishte Rodri që do shënonte si në "play-station", spanjollin nga larg ia doli të "shkundë

merimangat". Sommer sërisht protagonist në fund të fraksionit, pasi me një dalje i mohoi golin e dytë skuadrës së drejtuar nga Pep Guardiola. Anglezët do mund të dyfishonin shifrat në të 70-tën, me Silvan. Bavarezët bëjnë gafë në mbrojtje, gabim i cili rezultoi fatal. Vendasit do thellonin akoma më shumë shifrat, Erling Haaland do linte gjurmën e tij në këtë takim dhe do bënte që Manchester City të shkonte i qetë në ndeshjen e kthimit. Interi siguroi një rezultat të rëndësishëm në Lisbonë, fitore 0-2 në aktin e parë ndaj Benficës, duke hedhur kështu një hap të madh drejt kualifikimit. Të besuarit e Schmidt



ngacmuan të parët. Pas çerek ore lojë, portugezët do i afroreshin shumë golit të parë, goditje fantastike e Rafa Silvas brenda zonës, por e menjëhershme ishte përgjigja

e Onanas, i cili i tha jo me pritjen e tij. Nuk vonoi shumë edhe një tentativë e një ish-i si Joao Mario, por pa rezultat. Në mesin e pjesës së parë, Acerbi provoi me një gjuajtje nga distanca, sinjale të qarta të skuadrës së Inzaghit që shkaktuan drithërima në Lisbonë. Nico Barella do ndëshkonte grekun Odysseas Vlachodimos në fillimin e pjesës së dytë, me një gol me kokë, krosim magjik i Bastonit. Joao Mario do prekte topin me dorë në zonë 10 minuta nga fundi dhe arbitri akordoi penallti për mysafirët, pasi u këshillua me sistemin VAR. Nga pika e bardhë e penalltisë u tregua i saktë Lukaku. Ndeshja e kthimit luhet pas pak ditësh.

Çeku: Kosova është vend i sportit, por nuk do të tolerojmë aktivitetet ilegale



PRISHTINË, 11 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku ka theksuar se Serbia vazhdon me veprime dëmtuese ndaj Kosovës, në shkelje të plotë me mirëbesimin si bazë e marrëveshjes së fundit në procesin e dialogut. Ai ka thënë se letra e Federatës së Futbollit të Serbisë drejtuar presidentit të UEFA-së, përveç shtrembërimit të realitetit, përdor edhe gjuhë fyese. "Federatat e sportit të Kosovës për kohë të gjatë i kanë ftuar klubet sportive të komunitetit serb në

Republikën e Kosovës që të bëhen pjesë e sistemit legjitim sportiv në shtetin tonë", ka shkruar ministri Çeku në "Facebook". Ai ka shtuar se për vite, federatat e sportit të Serbisë kanë organizuar aktivitetet paralele dhe ilegal si pjesë e kampionateve të tyre zyrtare në zona të caktuara brenda territorit të Republikës së Kosovës. "Marrëveshja e fundit mes Kosovës dhe Serbisë, e ndërmjetësuar nga BE, veç tjerash, parasheh marrëdhënie të barabarta dhe të fqinjësisë së mirë.

Palët gjithashtu janë pajtuar të mos e përfaqësojnë njëra-tjetrën ndërkombëtarisht. Kosova është vend i sportit, por ne nuk do të tolerojmë aktivitetet ilegale që shkelin rendin tonë kushtetues dhe ligjor, si dhe kartat evropiane e botërore të sportit. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Federata e Futbollit e Kosovës është anëtare me të drejta të plota e UEFA dhe FIFA. U bëjmë thirrje të gjitha klubeve të sportit të bëhen pjesë e sistemit legjitim sportiv të Kosovës", ka theksuar Çeku.


Shaqiri: Ndaj Kosovës do kem shumë emocione, por do jap maksimumin

CYRIL, 11 PRILL - Xherdan Shaqiri ka folur për ndeshjen ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës, e vlefshme për kualifikimet për në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Në intervistën e dhënë për "The Guardian", Shaqiri ka thënë se ballafaqimi me Kosovën do të

jetë një moment krenarie, por që shprehet i bindur se do t'i bëhet një pritje e ngrohtë dhe se do të jetë moment shumë emocional. Ai shpreson se rikthimi i tij si futbollist në atë ndeshje kualifikuese do të jetë një përvojë krejtësisht më pozitive. "Unë luaj

për Zvicrën. Por unë kam lindur në Kosovë dhe i dua të dyja vendet. Unë do të jap 100% për Zvicrën. Me siguri do të jetë një moment krenarie. Do të shijoj çdo moment duke luajtur atje, sepse e gjithë familja ime do të vijë. Do të jetë emocionuese për

mua dhe jam i sigurt se do të kemi një pritje shumë të ngrohtë", ka thënë Shaqiri. Ndeshja ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, më 9 shtator të këtij viti.





**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenit 14 të Statutit të Ndërmarrjes me nr. prot. 04/5-202, të dt. 09.03.2023, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A., shpall:

KONKURS

Për pozitat:

I. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm/Sekretar/e i/e Ndërmarrjes

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në fushën e Fakulteti Juridik;
- Të posedoj së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes, korporatave ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të Ligjit Nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 04/L-111 neni 13;
- Preferohet të ketë njohuri të punës me kompjuter;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze;

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Shërben si Sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore e komunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin e Ndërmarrjes N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A.;
- Të siguroj përcjelljen e procedurave nga Bordi, ku bëjnë pjesë organizmi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bën përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës;
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe ti shpërndaj ato tek Drejtorët dhe Komisionit Komunal të Aksionarëve;
- Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga Kryesuesi i tyre) dhe ti regjistroj ato në librin e protokollit;
- Vepron si agjent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, Komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe Menaxhmentit të Lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të Ndërmarrjes duhet të jenë në dispozicion të të gjithë Drejtorëve të Bordit dhe duhet të siguroj që ato përpunohen me procedurat e Bordit;
- Mirëmban regjistrat e të dhënave të Ndërmarrjes;
- Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me Ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe Menaxhmentin e Ndërmarrjes për ndryshimet si dhe përgatit udhëzime të nevojshme për Menaxhmentin e Ndërmarrjes;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet nga ligji për Ndërmarrjet Publike ose nga Statuti i Ndërmarrjes;
- Koordinon me KE-në përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Merret me çështje tjera të qeverisjes së Ndërmarrjes sipas nevojës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën **Këshilltar/e i/e Përgjithshëm/Sekretar/e i/e Ndërmarrjes** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e aplikantit;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Kopjen e Letërnjoftimit.

II. Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e dhe i/e Thesarit (ZKFTH)

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar Fakulteti Ekonomik nga fusha e financave/kontabilitetit;
- Të posedoj përvojë profesionale së paku pesë (5) vite nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
- Preferohet të ketë shkathësi kompjuterike mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të Ligjit Nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 04/L-111 neni 13;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të Ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e Departamentit Financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e Ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;

- Kujdeset për pasurinë e Ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të Ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në Ndërmarrje, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare brenda ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e Ndërmarrjes për auditim;
- Mban përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKFTH i raporton KE-së si dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE dhe Bordi i Drejtorëve.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e Kryesor/e Financiar/e dhe i/e Thesarit (ZKFTH) duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e aplikantit;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Kopjen e Letërnjoftimit.

III. Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar Fakulteti Ekonomik nga fusha e financave/kontabilitetit;
- Përvoja e punës së paku pesë (5) vite në fushën profesionale;
- E preferuar njohja e gjuhës angleze.
- Preferohet njohja e mirë e punë me kompjuter (MC Office).

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Rregullisht shqyrton gjendjen financiare të Ndërmarrjes, kërkesat e planifikuar financiare dhe përmes vërejtjeve apo sugjerimeve njofton Komisionin e Auditimit kur e konsideron të nevojshme.
- Rregullisht e verifikon funksionimin e rregullt të kontroleve të brendshme dhe nëse e konsideron të nevojshme njofton Komisionin e Auditimit përmes vërejtjeve apo sugjerimeve me shkrim.
- Rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të punës të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i Ndërmarrjes duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahen në pajtim me standardet e kontabilitetit dhe ligjet në fuqi. Kujdes të veçantë ushtron që projekt – deklaratat financiare vjetore të përgatitet në mënyre të rregullt dhe lidhur me këtë ti raportoj Komisionit të Auditimit kur e konsideron të nevojshëm.
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat garantojnë se Ndërmarrja zbaton standardet dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Kryen vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative të Ndërmarrjes.
- Përcakton llojin dhe tekniken e auditimit të brendshme për secilin rast konkret duke u bazuar në ligjet pozitive, aktet normative praktiken e mire dhe njohurit profesionale.
- Koordinon mënyrën e bashkëpunimit me auditorët e jashtëm dhe kujdeset që palët të jenë në dijeni, siguron dokumentacionin e nevojshëm dhe raporton për fushat gjegjëse, financiare dhe te prokurimit por duke pasur për bazë konfidencialitetin.
- Propozon masat që duhet të ndërmerren nga Ndërmarrja për ngritjen e efikasitete dhe zbatimit të rregullave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Zbaton të gjitha rregullat dhe standardet të cilat kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm duke i raportuar KE-së, Komisionit të Auditimit dhe Bordit të Drejtorëve.
- Duhet të demonstroj integritet personal dhe profesional duke bashkëpunuar me Menaxhmentin, Komisionin e Auditimit dhe KE-në.
- Kryen edhe punë të tjera për të cilat kërkohet nga Menaxhmenti dhe Komisioni i Auditimit.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin;
- CV-në e aplikantit;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar (Fakulteti Ekonomik);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Certifikatë për auditor të licencuar;
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Kopjen e Letërnjoftimit.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Zyret qendrore të N.P.L. "Prishtina Parking" SH.A., Rr. "Luan Haradinaj", p.n., Pallati i Rinisë, 10000, Prishtinë, Kosovë. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. Konkursi është i hapur nga data: 12 Prill 2023 – 11 Maj 2023, ora 16:00.



**Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Na temelju odredaba članka 21. Zakona br. 03/L-087 o javnim poduzećima, odnosno odredbe članka 13. Zakona br. 04/L-111 o izmjenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 za javna poduzeća, kao i članak 14. Statuta poduzeća br. prot. 04/5-202, od 09.03.2023., Upravni odbor lokalnog javnog poduzeća "Prishtina Parking" S.A., objavljuje:

U G O V O R E N I

Za pozicije:

I. Glavni savjetnik/tajnik poduzeća

Osposobljenost i stručna sprema

- Kandidat mora imati visoku stručnu spremu pravnog smjera;
- Posjedovati najmanje pet (5) godina profesionalnog iskustva u području prava upravljanja, korporacija ili trgovačkih društava;
- Da ispunjava uvjete kvalifikacije prema članku 17.1. kao i ispuniti kriterije neovisnosti prema članku 17.2. točke (d), (f), (j), (k), (l), Zakona br. 03/L-087 o javnim poduzećima i izmjenama i dopunama Zakona o javnim poduzećima br. 04/L-111 članak 13.;
- Poželjno je poznavanje rada na računaru;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika;

Dužnosti i odgovornosti

- Obavlja dužnost tajnika Upravnog odbora i središnja je točka komunikacije s Općinskom komisijom dioničara o poslovanju Poduzeća N.P.L. "Prishtina Parking" dd;
- Osigurati praćenje procedura od strane Uprave, što uključuje organizaciju sastanaka Uprave, odbora Uprave i dioničara, te u suradnji s predsjednikom Uprave priprema i distribuira dnevni red;
- Voditi zapisnik sa sastanaka i dostavljati ga direktorima i Općinskom odboru dioničara;
- Voditi zapisnik sa svake sjednice Upravnog odbora i Revizorskog odbora (osim ako njihov predsjednik drugačije ne zatraži) i evidentirati ga u knjizi protokola;
- Djeluje kao agent Poduzeća za primanje obavijesti, kako bi se osigurao dobar protok informacija unutar Uprave, njegovih odbora i između Uprave i višeg rukovodstva Poduzeća;
- Savjeti i usluge tajnika Društva moraju biti dostupni svim direktorima Uprave i moram osigurati da se pridržavaju procedura Uprave;
- Vodi evidenciju podataka Poduzeća;
- Olakšava pravne promjene vezane za Poduzeće obavještavanjem Uprave i Uprave Poduzeća o promjenama, te priprema potrebne upute za Upravu Poduzeća;
- Obavlja sva arhiviranja, objave i/ili otkrivanja relevantnim tijelima, kako se može zahtijevati zakonom o javnim poduzećima ili Statutom poduzeća;
- Koordinira s EK pripremu dopisa (dokumenata) za sastanke Upravnog odbora;
- Po potrebi se bavi drugim pitanjima upravljanja poduzećem.

Procedura natjecanja

Kandidat za mjesto glavnog savjetnika/tajnika Društva dužan je priložiti sljedeće dokaze:

- Aplikacija;
- Životopis podnositelja zahtjeva;
- Dokaz o stručnoj spreml, ovjerena kopija (Pravni fakultet);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Reference i druge stručne potvrde;
- Motivacijsko pismo;
- Izjava pod prisegom (primljena i potpisana prilikom predaje dokumentacije);
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od šest (6) mjeseci);
- Kopija Obavijesti.

II. Glavni službenik za financije i riznicu

Osposobljenost i stručna sprema

- Visoko obrazovanje Ekonomski fakultet smjer financije/računovodstvo;
- Imati najmanje pet (5) godina radnog iskustva u području financija i računovodstva;
- Poželjno je poznavanje rada na računaru na naprednim sustavima iz područja financija/računovodstva;
- Da ispunjava uvjete kvalifikacije prema članku 17.1. kao i ispuniti kriterije neovisnosti prema članku 17.2. točke (d), (f), (j), (k), (l), Zakona br. 03/L-087 javnih poduzeća i izmjene i dopune Zakona o javnim poduzećima br. 04/L-111 članak 13.;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Dužnosti i odgovornosti

- Odgovoran je za provedbu svih finansijskih odredbi i računovodstvenih standarda, važećih zakona na Kosovu koji reguliraju finansijska pitanja i normativnih akata poduzeća;
- Organizira, vodi i kontrolira rad Finansijske službe;
- Odgovoran je za plaćanje finansijskih obveza sukladno finansijskim propisima;
- Vodi točnu evidenciju i dokumentaciju za ulaganja i plaćanja Društva;
- Prati važeće finansijske odredbe i stručnu literaturu te snosi odgovornost u slučaju neprimjenjivanja važećih zakona;
- Brine se o imovini Poduzeća, prati rad povjerenstava, kontrolira finansijske priljeve i odljeve općenito;
- Obavještava banke o finansijskom stanju i surađuje s bankarskim institucijama i drugim tijelima u interesu Poduzeća;
- Izrađuje periodične i završne račune;
- Odgovoran je za pripremu bankovnih prijenosa ili plaćanja s popratnom dokumentacijom i

uvjerava EK da je plaćanje uredno;

- Osmišljava, provodi i kontrolira provedbu finansijskih postupaka od strane podređenih;
- Odgovoran je za provjeru pravilnog vođenja arhive računovodstvene i finansijske dokumentacije;
- Razvija i provodi pravila unutarnje kontrole kao i upute i procedure za aktivnosti kao što su administracija proračuna, upravljanje imovinom i obvezama i vođenje računa;
- Odgovoran je za pravilnost procesa u funkciji računovodstva u Poduzeću, priprema i provodi računovodstvene procedure u skladu sa važećim zakonima na Kosovu, kao i kompetentno upravlja finansijskim resursima u okviru važećih zakona i propisa;
- Priprema podataka Društva za reviziju;
- Biti odgovoran za provođenje registracija i stanja imovine Poduzeća;
- Priprema periodična i godišnja izvješća Društva za EK i Upravni odbor.
- Brine se o kretanju troškova Poduzeća, plaćanju zakonskih obveza i poslovanju Poduzeća;
- ZKFTH izvještava EK kao i Upravni odbor;
- Obavlja i druge poslove za koje ga ovlasti EK i Upravni odbor.

Procedura natjecanja

Kandidat za mjesto glavnog direktora financija i riznice dužan je priložiti sljedeće dokaze:

- Aplikacija;
- Životopis podnositelja zahtjeva;
- Dokaz o stručnoj spreml, ovjerena kopija (Ekonomski fakultet);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Reference i druge stručne potvrde;
- Motivacijsko pismo;
- Izjava pod prisegom (primljena i potpisana prilikom predaje dokumentacije);
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od šest (6) mjeseci);
- Kopija Obavijesti.

III. Službenik za unutarnju reviziju

Osposobljenost i stručna sprema

- Sveučilišno obrazovanje Ekonomski fakultet iz područja financija/računovodstva;
- Radno iskustvo od najmanje pet (5) godina u struci na poslovima;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.
- Prednost je dobro poznavanje rada na računaru (MC Office).

Dužnosti i odgovornosti

- Redovito ispituje finansijsko stanje Poduzeća, planirane finansijske potrebe i primjedbama ili prijedlozima obavještava Komisiju za reviziju kada smatra da je to potrebno.
- Redovito provjerava pravilnost rada unutarnjih kontrola te, po potrebi, pisanim primjedbama ili prijedlozima obavještava Komisiju za reviziju.
- Redovito provjerava prikladnost i redovito funkcioniranje sustava rada i procedura kojima se želi osigurati da se knjige i dokumentacija Poduzeća, uključujući finansijsku dokumentaciju, vode u skladu s računovodstvenim standardima i važećim zakonima. Posebnu brigu posvećujem redovitoj izradi projektno-godišnjih finansijskih izvještaja, o čemu izvješćujem Komisiju za reviziju kada ocijeni da je to potrebno.
- Provjerava primjerenost i redovito funkcioniranje sustava i procedura koje jamče da tvrtka primjenjuje standarde i važeće zakone na Kosovu tijekom obavljanja svoje djelatnosti.
- Obavlja neovisnu procjenu učinkovitosti politika, procedura i standarda putem kojih se upravlja finansijskim, fizičkim i informacijskim resursima Poduzeća.
- Određuje vrstu i tehniku interne revizije za svaki konkretan slučaj na temelju pozitivnih zakona, normativnih akata, dobre prakse i stručnog znanja.
- Koordinira način suradnje s vanjskim revizorima i osigurava informiranost stranaka, osigurava potrebnu dokumentaciju i izvješća o odgovornim, finansijskim i nabavnim područjima, ali na temelju povjerljivosti.
- Predlaže mjere koje Društvo treba poduzeti radi povećanja učinkovitosti i primjene pravila tijekom obavljanja svoje djelatnosti.
- Provodi sva pravila i standarde vezane uz internu reviziju izvještavanjem EK, Revizorskom odboru i Upravnom odboru.
- Moram pokazati osobni i profesionalni integritet surađujući s Upravom, Odborom za reviziju i EK.
- Obavlja i druge poslove po nalogu Uprave i Odbora za reviziju.

Procedura natjecanja

Kandidat za radno mjesto službenika unutarnje revizije dužan je priložiti sljedeće dokaze:

- Aplikacija;
- Životopis podnositelja zahtjeva;
- Dokaz o stručnoj spreml, ovjerena kopija (Ekonomski fakultet);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Certifikat za ovlaštenog revizora;
- Reference i druge stručne potvrde;
- Motivacijsko pismo;
- Izjava pod prisegom (primljena i potpisana prilikom predaje dokumentacije);
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od šest (6) mjeseci);
- Kopija Obavijesti.

Pravo prijave imaju svi punoljetni državljani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju završeno odgovarajuće obrazovanje i stručnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti.

Ispunjene dokumente potrebno je dostaviti na adresu: Središnji uredi N.P.L. "Prishtina Parking" J.A., St. "Luan Haradinaj", p.n., Palata mladosti, 10000, Priština, Kosovo. Kandidati koji se natječu dužni su ispravno unijeti adresu i kontakt telefon te e-mail adresu. Samo odabrani kandidati bit će pozvani na razgovor. Nepotpuni dokumenti i oni koji pristignu nakon natječajnog roka neće se razmatrati. Natječaj je otvoren od: 12. travnja 2023. – 11. svibnja 2023. do 16:00 sati.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues